





E drejta për t'iu drejtuar gjykatës



Udhëzues për përdorim për Shqipëri



Tabela e përmbajtjes

1. Procedurat administrative

- 1.1 Plotësimi i ankesës administrative
- 1.2 Dorëzimi i ankimit në Gjykatën Administrative
- 1.3 Dorëzimi i një ankese tek Avokati i Popullit
- 1.4 Dorëzimi i një kërkesë në Inspektoratin e Mjedisit për kryerjen e një inspektimi

2. Kush e ka të drejtën të ngrrej një çështje?

- 2.1 E drejta për të ngritur një çështje nga individët
- 2.2 E drejta për të ngritur një çështje nga OJFtë

3. Si ti drejtohem gjykatës

- 3.1 Teknikat për të ngritur padinë
- 3.2 Në cilën gjykatë duhet të shkoj?
- 3.3 Afatet kohore
- 3.4 Kostot e gjyqit
- 3.5 A është rasti i pranueshëm?
- 3.6 Përgatitja për dëgjimin e palëve
- 3.7 Teknika të tjera të dobishme

3.8 Bllokimi i veprimtarisë gjatë marrjes së një vendimi (urdhër i përkohshëm pezullimi)

3.9 Si të kërkohet ndihmë (avokacia për interesin publik)

3.10 Përfshirja e ekspertëve

4. Paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike

5. Pengesat për t'ju drejtuar gjykatës

5.1 Kundër paditë

5.2 Kostot

5.3 E drejta e OJFve për t'ju drejtuar gjykatës

6. Proceset e apelimit ndërkombëtar

6.1 Mekanizmi i pajtueshmërisë dhe shqyrtimit të zbatimit

7. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Useful links

E drejta për t'ju drejtuar gjykatës sipas Konventës së Aarhusit (2017) është një Udhëzues i thjeshtë për tu përdorur prej organizatave të shoqërisë civile lidhur me të drejtat, mundësitë dhe rrugët për t'ju drejtuar gjykatës bazuar në kuadrin ligjor të vendit dhe përcaktimeve të Konventës së UNECE për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t'ju drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit. Ai jep këshilla praktike për fillimin e një çështjeje gjyqësore, zhvillimin dhe ndjekjen e procedurave administrative dhe gjyqësore, vënia në shfrytëzim e Institutit të Avokatit të Popullit, Komiteti i Pajtueshmërisë së Konventës së Aarhusit, dhe të tjera çështje. Ai bazohet në botimin e vitit 2004 "Zbatimi i Konventës së Aarhusit: Një udhëzues për përdoruesit e shoqërisë civile në Evropën Lindore dhe rajonin e Kaukazit". Përmbajtja e tij është rishikuar dhe përshtatur për Republikën e Shqipërisë.

Udhëzuesi i vitit 2004 është shkruar prej Magda Toth Nagy, Marianna Bolshakova, Kaidi Tingas, Rodica Iordanov dhe Pavel Antonov të Qendrës Rajonale të Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore (REC).

Botimi i tanishëm është përshtatur për Shqipërinë prej Besmir Beja.

Ky botim është rishikuar prej: Jela Bilandzija (Manaxhere projektesh) në REC. Përgatitja e botimit është drejtuar prej Gordana Kozhuharova (REC).

Botimi është mundësuar në kuadër të projektit "Qasje më e mirë në drejtësi në Evropën JugLindore", financuar prej Ministrisë Federale Gjermane për Mjedisin, Ruajtjen e Natyrës dhe Sigurinë Bërthamore si pjesë e Programit Këshillimor të Mbështetjes për mbrojtjen e mjedisit në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, të Kaukazit dhe Azisë Qendrore dhe vendeve të tjera fqinje me Bashkimin Evropian (AAP). Ai mbikqyret prej Agjencisë Federale të Mjedisit (Umweltbundesamt, UBA).

Çdo Kushtetutë e vendeve të rajonit garanton të drejtën për t'ju drejtuar gjykatës kur janë cënuar të drejtat. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton të drejtën për të apeluar kundër një vendimi ligjor të marrë në shkallë të parë prej një gjykatë, trupe administrative, organizate apo institucioni tjetër, i cili ushtron një mandat publik. Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë siguron të drejtën për një proces gjyqësor të drejtë dhe publik, brenda një afati kohor të arsyeshëm, prej një gjykate të pavarur dhe të paanshme për çdo individ, të cilit i janë cënuar të drejtat kushtetuese dhe siguruara me ligj, liritë apo interesat e tij.

Shqipëria ka miratuar procedurat e gjykimit për rastet e çështjeve civile, penale dhe administrative.

Në Tetor 2000, Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Komisionit Ekonomik për Evropën të Kombeve të Bashkuara (UNECE) për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit (Konventa e Aarhusit), e cila hyri në fuqi në Nëntor të po atij viti. Që atëherë, Shqipëria ka përshtatur legjislacionin në mënyrë që të sigurojë të drejtën për t'ju drejtuar gjykatës nëse cënohet e drejta për të marrë informacion dhe për të marrë pjesë në vendimmarrje, sipas shtyllës së tretë të Konventës, e cila trajton çështje të së drejtës për të apeluar kundër vendimeve dhe veprimeve që kufizojnë të drejtën e informimit ose shmangin pjesëmarrjen në proceset e vendimmarrjes.

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, publiku i interesuar ka të drejtën të kërkojë prej autoriteteve publike të ndërmarrin masat e duhura për mbrojtjen e mjedisit ose të fillojnë procese për rishikimin e vendimeve lidhur me mjedisin të marra prej gjykatave. Publiku ka të drejtën të apelojë kundër vendimeve të çdo institucioni lidhur me mbrojtjen e mjedisit, dhe të drejtën të nisë një proces gjyqësor në gjykatat administrative sipas Kodit të Procedurës Administrative dhe Ligjit për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative.

Në përgjithësi, qytetarët në Shqipëri nuk kanë besim të drejtohen sistemit gjyqësor në vend dhe të nisin procese apeli, sepse kanë perceptimin që ka korrupsion, proceset janë të ngadalta, kanë mungesë besimi në sistemin gjyqësor ose ju mungon njohja e duhur ligjore për këto procese. Megjithatë, Shqipëria ka ndërmarrë një reformë rrënjësore të sistemit të drejtësisë që ka si qëllim të rikthejë besimin e publikut në sistemin gjyqësor dhe veprimin e ligjit. Gjithashtu, prej gjykatave administrative janë marrë në shqyrtim një numër i shtuar çështjesh administrative kundër vendimeve të institucioneve shtetërore.

Siç parashikohet me ligj, çështjet administrative trajtohen me një procedurë të shkurtuar që bën të mundur përfundimin e çështjes në një kohë më të shkurtër dhe me më pak kosto të përfshira. Megjithatë duhet theksuar që për shkak të një numri të madh çështjesh që janë në ndjekje në gjykatat administrative, koha e ndjekjes së çështjeve administrative është më e gjatë se sa parashikohet në ligj për ndjekjen e çështjeve të tilla administrative.

Shqipëria ka një kuadër ligjor modern për të drejtën e informimit, që rregullon qoftë të drejtën për të marrë informacion të përgjithshëm të përgatitur apo të disponueshëm prej institucioneve shtetërore, ashtu edhe të drejtën për të marrë informacionin në lidhje me mjedisin. Bazuar në këtë kuadër ligjor modern nuk është e vështirë të fitohen çështje që lidhen me të drejtën e informimit. Të gjithë personat fizikë apo juridik, shqiptarë apo të huaj, kanë të drejtën ligjore të ngrenë padi ndaj vendimi që kufizon të drejtën për të marrë informacion. Përpara ngritjes së padisë në një gjykatë administrative në Shqipëri, çdo individ duhet të paraqesë një ankesë administrative kundër vendimit të autoritetit publik lidhur me kërkesën për të drejtën e informimit tek një autoritet më i lartë i pavarur, tek Komisioneri për të drejtën e informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ("Komisioneri"). Komisioneri është një autoritet i pavarur i ngarkuar me dy funksione të ndara: (a) në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave, është i ngarkuar për mbikqyrjen e mbrojtjes së të dhënave personale si dhe (b) në përputhje me Ligjin për të drejtën e informimit, është autoriteti kompetent për të shqyrtuar ankesat kundër autoriteteve të tjera publike dhe të shërbejë si organi më i lartë publik ku mund të kryhet apeli administrativ. Gjithashtu, Komisioneri ka të drejtën të ndërmarrë hetime administrative për grumbullimin e fakteve për një çështje të caktuar, të vendosë gjoba për rastet e shkeljeve në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit si dhe është përgjegjës për të siguruar zbatimin në tërësi të ligjit për të drejtën e informimit. Komisioneri propozohet prej Këshillit të Ministrave dhe zgjidhet me votim nga Kuvendi i Shqipërisë.

E drejta për informacionin mjedisor garantohej prej ligjit për mbrojtjen e mjedisit dhe akteve të tjera nënligjorë, dhe Ligjit për të drejtën e informimit. Në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e mjedisit dhe Ligjin për të drejtën e informimit, marrja e informacionit për mjedisin duhet të sigurohet brenda 10 ditëve prej datës së dorëzimit të kërkesës për informacion. Duke marrë në konsideratë se të dy ligjet, ai për të drejtën e informimit dhe ligji për mbrojtjen e mjedisit përcaktojnë jo vetëm detyrimin për dhënien e informacionit, por japin afatet kohore të dhënies së informacionit, me shumë gjasë, gjykatat do të vendosin në favor të personit që e kërkon informacionin. Në praktikë, meqë ka një numër shumë të lartë ankesash administrative, Komisioneri për të drejtën e informacionit dhe të mbrojtjes së të dhënave personale shqyrton ankesën dhe urdhëron autoritetet përkatëse ti japin aplikuesit informacionin e kërkuar. Në këto kushte jo vetëm që sigurohet marrja e informacionit të kërkuar, por procesi fiton edhe një vlerë të shtuar. Çështja e shqyrtuar përbën një precedent që nënkupton se kur më vonë, një person në një rast të ngjashëm do ta kishte çështjen e tij më të lehtë. Gjithashtu, pritjet që në pak vite autoritetet ti kushtojnë vëmendje më të madhe kthimit të përgjigjeve ndaj kërkesave prej publikut, sepse do ta kuptojnë që është më e lehtë të jepet informacioni i kërkuar sesa të harxhohet kohë nëpër gjykata. Sipas Konventës së Aarhusit, Shqipëria është e detyruar të miratojë kuadrin ligjor të plotë për zbatimin e Konventës. Kuadri ligjor kombëtar duhet të sigurojë është zbatimin e duhur të saj. Ndonëse Kushtetuta e Shqipërisë përcakton se të gjitha marrveshjet ndërkombëtare janë detyruesisht të zbatueshme dhe prelojnë në raport me kuadrin ligjor kombëtar, në realitet vendi nuk ka ndërmarrë të gjithë hapat ligjorë dhe masat e tjera të nevojshme për të siguruar zbatimin efektiv të Konventës. Sipas Nenit 9 të Konventës së Aarhusit, një person mund të paraqesë ankimim administrativ apo juridik në një gjykatë nëse:

1. Është cënuar e drejta për marrjen e informacionit (Neni 9.1)
 - Informacioni i dhënë nuk është i plotë dhe / ose nuk është në përputhje me kërkesën.
 - Kërkesa për informacion është refuzuar.
 - Nuk është kthyer përgjigje brenda afatit kohor të përcaktuar me ligj (p.sh. një [ose më shumë se një] muaj).
2. Është cënuar e drejta për të marrë pjesë (Neni 9.2)
 - Nuk është dhënë njoftimi për procedurën e vendimmarrjes.
 - Mjetet e përdorura për të dhënë njoftimin kanë qenë të pamjaftueshme për të mbritur tek publiku i interesuar.
 - Njoftimi është dhënë në një fazë të vonuar të procedurës së vendimmarrjes.
 - Njoftimi nuk përmban minimumin e kërkuar të informacionit.
 - Nuk jepet informacion i hollësishëm rreth projektit, programit ose planit.
 - Procedura nuk lejon dhënien e komenteve.
 - Komentet nuk janë marrë në konsideratë sipas rasteve të mëposhtme:
 - Vendimmarrësi nuk mund të shpjegojë në mënyrë të arsyetuar përse një koment i dhënë nuk është përfshirë në vendimin përfundimtar.
 - Vendimi nuk është shpallur.
 - Vendimi i shpallur nuk përfshin argumentimin e vendimit
3. Janë shkelur **ligjet për mjedisin** (Neni 9.3)
 - Mund të ankimohen veprimet apo mosveprimet e personave fizikë që shkelin ligjet për mjedisin.
 - Mund të ankimohen veprimet apo mosveprimet e autoriteteve publike që shkelin ligjet për mjedisin.

Ky përcaktim përmban disa kushte, përfshirë të drejtën për të ngritur një çështje, e cila përmbush disa kritere, zakonisht kur preket një interes i caktuar. Kjo dispozitë përmban disa kushte, përfshirë edhe të drejtën për të ngritur një çështje me kusht që të përmbushë disa kritere — zakonisht një interes i cënuar. Kjo e drejtë njihet si e “drejta për të cuar një çështje në gjykatë”. Neni 9 i Konventës i jep status të veçantë OJFve mjedisore (shih 2.2), i njeh atyre që kanë një interes për t’ju drejtuar gjykatës dhe kanë të drejtë për të marrë pjesë në vendimmarrjen, e për rrjedhojë kanë të drejtën e përfaqësimit për të ngritur çështje të tilla në këto institucione.

Figure 1. Steps in exercising the right to free access to information

Mundësia për të pasur një procedurë apelimi jepet sipas rrugës që duhet ndjekur për rastet e apelimit administrativ në nivelet më të larta të vendimmarrjes dhe përmes gjykatave. E drejta për të procedurën e ankimit mund të ushtrohet përmes ankimit administrativ në organet më të larta të vendimmarrjes dhe përmes gjykatave. Nëse rrugët për t'ju drejtuar gjykatës nuk janë mundësuar, ekzistojnë disa procedura në nivel ndërkombëtar që përfshijnë Mekanizmin e Pajtueshmërisë të vetë Konventës dhe në disa raste edhe Gjykatën e Evropiane të Drejtave të Njeriut (shih kapitujt 6 dhe 7).

1. Procedurat administrative

E drejta për t'ju drejtuar gjykatës mund të ushtrohet në gjykatë dhe përmes dëgjësës së palëve. Megjithatë ka disa rrugë të tjera për të apeluar kundër një vendimi. Rrugët më të zakonshme kanë të bëjnë me apelimin administrativ, apelimin tek Avokati i Popullit dhe apelimin në Prokurori. Në disa raste, apelimi administrativ është parakusht për të filluar procedurën për një çështje administrative në gjykatë.

Për këtë arsye është e rëndësishme të përcaktohet strategjia më e mirë që duhet ndjekur për çdo rast të dhënë. Zgjidhja përmes gjykatës mund të kërkojë kohë të gjatë dhe shpesh ka shpenzime të konsiderueshme. Më poshtë jepet një përshkrim i katër rrugëve se si mund të përdoret e drejta për t'ju drejtuar gjykatës në përputhje me kuadrin ligjor shqiptar. Sidoqoftë, duhet mbajtur parasysh se efektiviteti i procedurës ndryshon rast pas rasti.

- 1.1 Plotësimi i ankesës administrative
- 1.2 Depozitimi i ankimit në Gjykatën Administrative
- 1.3 Depozitimi i ankimit pranë Avokatit të Popullit
- 1.4 Dorëzimi i kërkesës për të kryer inspektim në Inspektoratin e Mjedisit

1.1. Plotësimi i ankesës administrative

Nëse nuk jeni të kënaqur me vendimin administrativ ose në rast se vendimi nuk është miratuar prej autoritetit publik brenda afatit kohor të përcaktuar me ligj, ju mund të përdorni rrugët ligjore administrative. Sipas Kodit të Procedurave Administrative, pala mund të përdorë rrugën ligjore administrative për të kundërshtuar një vendim administrativ ose mos ndërmarrjen e një veprimi administrativ (p.sh. nëse nuk është marrë një vendim brenda afatit kohor të përcaktuar me ligj): (a) apelimi administrativ në të dy format e tij: si një ankimim administrativ kundër një akti administrativ dhe kundër një kundërshtimi administrativ; dhe (b) si kërkesë për rihapjen e çështjes.

1.1.1 Ankimimi kundër një akti administrativ

Një apelim administrativ, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe nga ligji, mund të bëhet kundër një akti administrativ ose për mosveprim të një organi publik që duhet ta lëshonte atë akt brenda afatit kohor të përcaktuar me ligj. Apelimi administrativ duhet të përmbajë të paktën informacionin në vijim: (a) emrin e subjektit që bën apelimin, (b) autoritetin publik që shqyrton ankimit administrativ; (c) titullin, numrin dhe datën e aktit administrativ që ankimohet ose të aktit administrativ që duhej nxjerrë prej autoritetit publik, por që nuk ka vepruar sipas kërkesës së paraqitur; (d) objektin dhe shkakun e ankimit. Ankimimi duhet të mbajë parasysh dhe ti referohet afateve kohore të parashikuara me ligj, përndryshe edhe në rastet kur ankimimi mund të pranohet, kjo gjë mund të mos ndodhë për shkak të mbarimit të periudhës së ankimit. Kodi i Procedurave Administrative parashikon që ankimimi administrativ duhet të paraqitet brenda 30 (tridhjetë) ditëve, duke filluar nga dita e njoftimit të palës së interesuar për aktin administrativ ose kundërshtimin për të nxjerrë një akt të tillë.

Në rastet e mosveprimit administrativ, përveç rasteve të zbatimit të miratimit në heshtje, ankimimi nuk duhet dorëzuar më herët se 7 (shtatë) ditë apo më vonë se 45 (dyzet e pesë ditë) ditë nga data e përfundimit e afatit kohor apo data e përcaktuar për zgjatjen e afatit kohor të përmbushjes së procedurës administrative.

Pavarësisht shanceve për të fituar, është gjithnjë e këshillueshme që të depozitohet ankimimi administrativ për dy arsye: e para, si rregull i përgjithshëm, shterri i të gjitha rrugëve administrative ligjore është parakusht për të filluar një çështje gjyqësore në gjykatat administrative kundër një akti administrativ; dhe së dyti, përveç rastet kur parashihet ndryshe në ligj, fillimi i një çështjeje gjyqësore bllokton zbatimin e një akti administrativ deri në shqyrtimin e ankimit prej autoritetit publik kompetent dhe deri në njoftimin e palës së interesuar për vendimin e rishqyrtimit e procedurës administrative.

Për shqyrtimin administrativ, ankesa mund ti dërgohet organit që e ka lëshuar ose atij kompetent për të lëshuar një akt administrativ, një organi publik më të lartë se ai që ka lëshuar aktin ose që është kompetent për të lëshuar aktin, ose mund ti dërgohet një organi tjetër publik në rastet të veçanta të përcaktuara specifikisht me ligj. Nëse ankesa i drejtohet një organi më të lartë publik, autoriteti duhet tja dërgojë atë menjëherë organit publik kompetent.

Ankimimi kundër një akti administrativ duhet shqyrtuar fillimisht prej vetë organit publik kompetent, nëse nuk parashikohet ndryshe me ligj. Si rregull i përgjithshëm, organi publik kompetent duhet të nisë me vlerësimin nëse ankesa është e vlefshme, dhe vetëm në këtë rast, ai shqyrton legjitimitetin dhe lidhjen e përmbajtjes së ankesës me aktin administrativ. Nëse është e domosdoshme, organi publik kompetent ndërmerr edhe procese të tjera shtesë të shqyrtimit administrativ.

Nëse organi publik kompetent përcakton se ankimimi është i drejtë dhe i bazuar në ligj, ai lëshon një akt administrativ që anulon, tërheq apo ndryshon aktin e ankimit, ose nxjerr aktin e lëshuar nga pala e interesuar në rastin kur organi publik ka refuzuar të ndërmarrë një veprim të tillë më parë. Akti administrativ duhet nxjerrë dhe pala e interesuar duhet njoftuar brenda 30 ditëve nga dorëzimi i ankesës.

Nëse organi publik kompetent përcakton se ankimimi nuk është i drejtë dhe nuk mund të ndryshojë vendimin e marrë me një akt të ri, atëherë ai duhet tja dërgojë menjëherë për vlerësim një organi publik më të lartë, së bashku me të gjithë dokumentacionin e dosjes dhe me një relacion përshkruar të qëndrimit të tij për këtë çështje. Organi më i lartë publik mund ta (a) refuzojë ankimimin; (b) refuzojë ankimimin, por të japë arsye të tjera dhe (c) nëse ankimimi pranohet dhe është i bazuar në ligj, të nxjerrë një akt të ri.

Organi më i lartë publik mund ta refuzojë ankimimin nëse përcakton se procedura e ndjekur në shkallën e parë është zbatuar në mënyrën e duhur, nëse vendimi është i duhur dhe i bazuar në ligj dhe nëse ankimimi nuk është i bazuar. Nëse organi më i lartë publik gjen se pjesa urdhëruese e vendimit të ankimit është në përputhje me ligjin, por argumentimi i dhënë prej autoritetit publik për miratimin e këtij vendimi nuk është i plotë ose duhet bërë argumentim i ndryshëm për miratimin e aktit administrativ, ai mund të vendosë ta refuzojë ankimimin dhe të japë një argumentim të ri. Nëse organi publik më i lartë gjen të bazuar në faktet e dhëna, çështjes administrative i duhet dhënë një zgjidhje e ndryshme prej asaj të dhënë prej organit publik kompetent, me anë të një akti të ri, atëherë ai mund ta anulojë, ta tërheqë apo ta ndryshojë të gjithin apo pjesë të caktuara të aktit të ankimit.

Vendimi për ankimimin duhet bërë dhe i duhet dërguar palës së interesuar sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 30 ditë nga data e marrjes së ankimit, nëse nuk është përcaktuar një afat kohor më i shkurtër me ligj të veçantë. Ankimimi pezullon zbatimin e vendimit, përveç rasteve tepër caktuara në ligj që përcaktojnë se ankimimi nuk mund të vonojë ekzekutimin e vendimit.

Vendimet administrative të marra përmes një procedure të ankimit administrativ, si dhe ankimet administrative, për të cilat procedura administrative nuk përcaktohet, janë subjekt i mosmarrveshjeve administrative (shih 1.2).

SHEMBULL



Organi publik më i lartë

Inspektorati i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujrave është institucioni përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kuadrit ligjor për mbrojtjen e mjedisit dhe të pyjeve. Inspektorati është i organizuar me një drejtori qendrore dhe disa degë rajonale. Degët rajonale kanë të drejtën të kryejnë inspektime dhe vendosin gjopa për kundravajtje sipas ligjit në fuqi. Gjopa është një akt administrativ që lëshohet prej degëve rajonale. Inspektorati Qendror është një organ publik më i lartë sesa degët rajonale. Prandaj, ky organ publik më i lartë (Inspektorati Qendror) nuk merr në shqyrtim ankesa mund të (a) refuzojë ankesën; (b) refuzojë ankesën por të japë arsyetim shtesë të ri dhe (c) nëse ankesa pranohet dhe gjendet i bazuar në ligj, të nxjerrë një akt të ri.

SHEMBULL



Zbatimi praktik i ligjit

Një grup banorësh të fshatit Bënçë në Tepelenë, që jetojnë përgjatë lumit të Bënçës kanë kërkuar informacion prej Ministrisë së Energjetikës dhe Industrisë lidhur me një kontratë për ndërtimin dhe funksionimin e një hidrocentrali mbi Lumin e Bënçës. Ministria ka refuzuar kërkesën për informacion duke e justifikuar veprimin e saj me faktin se kontrata përmban të dhëna për biznesin dhe, si të tilla, ato klasifikohen si sekret tregëtar. Banorët kanë vendosur kontakte me një organizatë jofitimprurëse vendore, e cila bazuar në Nenet 3, 11 dhe 17 të Ligjit për të Drejtën e Informimit, argumentoi se kërkesa për të drejtën e informacionit falas lidhur me kontratën për ndërtimin dhe funksionimin e një hidrocentrali nuk mund të refuzohet. Banorët, të përfaqësuar nga kjo organizatë, e paraqitën ankesën e tyre tek Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informacionit duke kërkuar ushtrimin e të drejtës së tyre për të marrë informacionin e kërkuar.

1.1.2 Kundërshtimi administrativ

Kodi i Procedurave Administrative të Shqipërisë, siç është shpjeguar më lart, i jep të drejtën për të bërë ankimim jo vetëm kundër një akti administrativ ose në rastin e mosveprimit administrativ, por gjithashtu edhe kundër një veprimi tjetër administrativ, i cili është në fuqinë vepruese të ligjit administrativ. Një kundërshtim administrativ mund të depozitohet kundër një veprimi administrative, i cili nuk përmbush kriteret për tu klasifikuar si akt administrativ ose mosveprim administrativ.

Kur një palë depoziton një kundërshtim administrativ, ajo mund të kërkojë prej organit publik (a) ndalimin e kryerjes së një veprimi tjetër administrativ; (b) kryerjen e një veprimi administrativ, i cili duhet kryer prej një pale të caktuar, nëse veprimi kërkohet prej palës së interesuar, por organi publik nuk ka mundur të veprojë; (c) tërheqjen ose ndryshimin e një deklarate publike; dhe (d) deklarimin të pavlefshëm të një veprimi tjetër administrativ dhe korigjimin e pasojave të tij.

Gjithashtu, përmes një kundërshtimi administrative, një palë mund të kërkojë ushtrimin e funksioneve rregullatore ose të mbikqyrjes prej organeve rregullatore, mbikqyrëse apo licensuese, në rastet kur një ndërmarrje e shërbimeve publike apo çdo ndërmarrje tjetër publike nuk mund të japë shërbimin e duhur. Në këtë rast kundërshtimi administrativ synon të detyrojë organin rregullator, që ka funksion mbikqyrës për organin që ofron shërbime publike, të ushtrojë fuqinë mbikqyrëse dhe të sigurojë se ndërmarrja e shërbimeve publike të veprojë në përputhje me legjislacionin në fuqi (sigurimi i tërthortë i shërbimeve publike).

Kundërshtimi administrativ duhet të dorëzohet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita kur pala e interesuar është njohur me faktin që kundërshton. Në rastet ku një palë kërkon sigurimin e tërthortë të shërbimeve publike, kundërshtimi publik i drejtohet dhe merret në shqyrtim prej organit publik rregullator, mbikqyrës apo licensues. Në rastet kur një palë kërkon (a) ndalimin e kryerjes së një veprimi tjetër administrativ; (b) tërheqjen ose ndryshimin e një deklarate publike; dhe (c) deklarimin të pavlefshëm të një veprimi tjetër administrativ dhe korigjimin e pasojave të tij, kundërshtimi administrativ i drejtohet dhe merret në shqyrtim prej organit kompetent. Ky i fundit, në rastet kur një palë kërkon kryerjen e një veprimi tjetër administrativ, i cili parashikohet me ligj për tu kryer prej saj, por kur organi publik ka dështuar për të vepruar, kundërshtimi administrativ i drejtohet dhe merret në shqyrtim prej një organi më të lartë. Në këtë rast, nëse organi më i lartë merr vendim në favor të palës kërkuese, ai vendos një afat kohor për organin kompetent që të ndër marrë dhe kryejë veprimin administrativ siç kërkohet nga pala e interesuar.

Vendimi në favor të kundërshtimit administrativ duhet marrë dhe njoftuar pala kërkuese brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e dorëzimit të tij. Nëse kundërshtimi administrativ nuk shqyrtohet brenda afatit kohor të përcaktuar ose refuzohet, pala kërkuese mund të hapë një çështje gjyqësore në gjykatën kompetente për çështjet administrative..

1.1.3 Rihapja

Ruga ligjore administrative e fundit e përcaktuar prej Kodit të Procedurave Administrative të Shqipërisë për të kundërshtuar një vendim administrativ apo një mosveprim administrativ është rihapja. Një palë ka të drejtë të kërkojë rihapjen nëse zbulohen kushte të reja ose grumbullohen fakte të shkruara të reja të lidhura me çështjen. Megjithatë, duhet të plotësohen dy kushte (1) këto të dhëna të reja nuk ishin të njohura ose nuk mund të njoheshin prej palës kërkuese gjatë kryerjes së procedurës administrative të ndjekur për marrjen e atij vendimi administrativ dhe (2) pala nuk mund të depozitonte një ankimim kundër aktit administrativ për shkak të kalimit të afatit kohor të përcaktuar me ligj.

Kërkesa për rihapjen duhet dorëzuar brenda 30 ditësh nga data kur pala kërkuese është njohur me rrethanat e reja ose me faktet e reja të shkruara që kanë lidhje me çështjen. Megjithatë, në çdo rast, rihapja nuk pranohet nëse kanë kaluar më shumë se 2 vjet prej ndodhjes së arsyes që kërkon hapjen e çështjes. Kërkesa i dorëzohet të njëjtit organ që ka nxjerrë apo refuzuar të nxjerrë aktin administrativ që është subjekt i kërkesës për rihapje.

1.2 Dorëzimi i ankimit në Gjykatën Administrative

Mosmarrveshjet administrative në Shqipëri zgjidhen prej një sistemi të specializuar gjykatash administrative.

Sistemi i gjykatave administrative është i përbërë prej gjykatave administrative të shkallës së parë (në Tiranë, Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë) dhe një gjykatë apeli që gjendet në Tiranë. Gjithashtu, Gjykata e Lartë ka një dhomë administrative të specializuar e ngarkuar me shqyrtimin e çështjeve administrative. Gjykata vendos mbi ligjshmërinë e aktit administrativ, si dhe veprimet e tjera administrative që përcaktojnë apo ndikojnë mbi ushtrimin e të drejtës, detyrimeve dhe interesave ligjore të një personi fizik apo juridik siç kërkohet prej ligjit. Mosmarrveshjet administrative shqyrtohen pasi është hapur çështja gjyqësore.

Një çështje e lidhur me një mosmarrveshje administrative mund të hapet kundër:

- një veprimi administrativ të nivelit të dytë (një veprim administrativ që është nxjerrë ose shqyrtuar prej një organi publik me të lartë pas depzimitit të ankesës prej një pale të interesuar);
- një veprimi administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit nuk lejohet ankimi ose kundërshtimi sipas procedurës administrative, ose veprimeve administrative të parashikuara me ligj; ose
- një autoriteti publik që ka dështuar të nxjerrë një akt administrativ ose të ndër marrë një veprim administrativ (p.sh. që qëndruar në heshtje administrative pa vendosur lidhur me ankimin e palës kërkuese).
- Një akt administrativ ose një veprim administrativ tjetër mund të kundërshtohet në raste të:
 - moszbatimit të rregullave të procedurës;
 - parashtrimit jo të saktë ose jo të plotë të fakteve; ose
 - zbatimit jo të drejtë të ligjit mbi të drejtën materiale

Gjatë paraqitjes së ankesës, paditësi (ose personi i interesuar) duhet të paraqesë informacionet e mëposhtme:

- Gjykatën në të cilët depozitohet çështja;
- Emrin, emrin e babait, mbiemrin vendbanimin ose vendqendrimin e përkohshëm të paditësit, të pandehurit dhe të personave përfaqësojnë palët e interesuara, nëse ka të tillë. Nëse paditësi ose i pandehuri janë persona juridikë, atëherë jepet emri siç është i regjistruar në regjistrat publikë, adresa e zyrës apo të zyrave qendrore, ku duhet dërguar njoftimi.
- Aktin administrativ ose veprimin administrativ kundër të cilit depozitohet ankesa;
- Një përshkrim të fakteve konkrete, rrethanave, dokumentave dhe provave të tjera mbi të cilat bazohet padia si dhe kërkesa konkrete e paditësit;
- Vlera e padisë, nëse subjekti i çështjes mund të përlllogaritet

Dosjes së padisë i duhet bashkëlidhur dokumenti original ose kopja e noterizuar e vendimit kundër të cilit ngrihet padia ose prova të aktivitetit administrativ që paditet.

Nëse kërkohet dëmshpërblim ose kompensim prej kësaj çështje gjyqësore, padia duhet të përfshijë gjithashtu kërkesën për rikthimin e sendit ose të shumës së dëmit të shkaktuar. Padia depozitohet në Gjykatat Administrative personalisht ose përmes postës. Si rregull, padia nuk e bllokoi zbatimin e një akti administrativ — që rrjedh si efekt ligjor i veprimeve të tjera administrative kundër padisë së ngritur. Nëse autoriteti publik nuk e ka bllokuar zbatimin e aktit administrativ deri në kohën e marrjes së vendimit përfundimtar për këtë çështje administrative, me kërkesën e paditësit gjykata mund të bllokojë zbatimin e aktit administrativ ose të efekteve ligjore të veprimeve të tjera administrative të varura prej vendimit të gjykatës nëse, me zbatimin e aktit administrativ ose prej efekteve ligjore të veprimtarive të tjera administrative, mund të shkaktohen dëme të riparueshme, nëse vonesa nuk cënon seriozisht interesin publik. Me kërkesë të paditësit, gjykata merr një vendim, jo më vonë se pesë ditë prej datës së marrjes së aplikimit.

Gjykatat Administrative mund ta kthejnë aplikimin nëse përcaktojnë se padia nuk plotëson kërkesat zyrtare për ngritjen e padisë. Gjykata administrative mund ta refuzojë padinë nëse e gjen veprimin administrativ të bazuar në ligj dhe të mbështetur në prova.

Gjykatat Administrative i gjykojnë rastet e mosmarrveshjeve administrative të shkallës së parë, mbi bazën e shpjegimeve verbale. Si fillim, brenda 7 ditësh nga dorëzimi i kërkesë-padisë, gjyqtari kryesues ndërmerr një numër veprimesh përgatitore, të cilat përfshijnë: njoftimin e të pandehurit të padisë dhe të akteve që e shoqërojnë atë, përcakton afatin kohor deri në 10 ditë për të pandehurin që të depozitojë argumentat e tij me shkrim, listën e personave që i pandehuri kërkon të thirren në gjyq në cilësinë e dëshmitarit apo të ekspertit, dhe adresat e tyre, si dhe tërë aktet e shtypura, mbi të cilat është bazuar nxjerrja e vendimit administrativ dhe është shqyrtuar çështja gjatë ankimit administrativ. Në rastet kur nevojitet mendimi i ekspertit, gjykatësi merr vendimin për të caktuar një ekspert që të japë mendimin e ekspertit.

Pasi janë kryer të gjitha veprimet përgatitore, gjyqtari kryesues lëshon një urdhër ku përcaktohet data dhe koha e dëgjimit të palëve. Periudha e caktuar për dëgjimin e palëve nuk duhet të jetë më e gjatë se 15 ditë.

Legjitimiteti i aktit administrativ që kundërshtohet ose i veprimeve të tjera administrative shqyrtohet prej Gjykatave Administrative brenda kuadrit të padisë, pa qenë të lidhura ngushtësisht me çështjen që trajtohet në kërkesë padinë. Në vendimin e saj, gjykata pranon padinë si të bazuar në prova, ose ta refuzojë atë si të pabazuar në fakte. Nëse gjykata e pranon padinë, ajo ndërmerr veprimet e mëposhtme:

- Tërheq aktin administrativ të plotë ose pjesërisht;
- Ndryshon aktin administrativ në tërësi ose pjesërisht ose detyron organin publik të ndryshojë një akt administrativ;
- Gjen aktin administrativ si tërësisht të pavlefshëm;
- Detyron organin publik të ndërmarrë veprimin administrativ që është refuzuar ose për të cilin organi publik ka qëndruar në heshtje ndonëse ka marrë një kërkesë për të;
- Gjen veprimin administrativ të paligjshëm, por që nuk prodhon më pasoja ligjore, nëse paditësi ka interes të arsyeshëm për të;
- Përcakton më mirë të drejtat dhe detyrimet ndërmjet paditësit dhe organit publik;
- Detyron organin publik të veprojë ose ndalojë kryerjen e një veprimi tjetër administrativ, i domosdoshëm për të mbrojtur të drejtat ose interesat e paditësit;
- Përcakton organin që është kompetent për të zgjidhur rastin konkret, si dhe urdhëron nëse është rasti, tërheqjen e një akti të lëshuar prej një organi jo kompetent;
- Kompensimin e dëmeve jashtë kontraktore, sipas një ligji të veçantë;
- Zgjidhjen e mosmarrveshjeve të punës, kur punëdhënësi është një organ i administratës publike

Vendimi i gjykatave administrative të shkallës së parë mund të apelohej në Gjykatën Administrative të Apelit në Tiranë. Megjithatë, duhet vërejtur se jo çdo vendim mund të apelohej. Aktet ose kundravajtjet administrative me vlerë më të vogël se njëzet fishi i pagës minimale nuk shqyrtohen prej Gjykatës Administrative të Apelit.

Si rregull, Gjykata Administrative e Apelit vendos në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve. Megjithatë, dëgjimi me praninë e palëve mund të mbahet në rastet e mëposhtme.

- Kur duhen verifikuar faktet e reja dhe provat e reja të grumbulluara për të njohur gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë;
- Kur vendimi kundër të cilit është kryer apelimi është marrë një shkelje të rëndë të procedurave ose është bazuar në gjendje faktike të gabuar ose në mënyrë jo të plotë;
- Kur gjendja faktike është e saktë, por duhet përsëritur marrja e një pjese të provave apo e të gjithë provave prej gjykatës së shkallës së parë.

Rekursi kundër vendimit përfundimtar të Gjykatës Administrative dhe kërkesa për rihapjen e shqyrtimit duhet depozituar kundër vendimit përfundimtar të Gjykatës Administrative. Gjykata e Lartë e Shqipërisë vendos për rekursin dhe Gjykatat Administrative vendosin për rihapjen e shqyrtimit.

1.3 Dorëzimi i një ankese tek Avokati i Popullit

Institucioni i Avokatit të Popullit ka lindur në Skandinavi dhe ka kuptimin e “përfaqësuesit të popullit”. Avokati i Popullit përfaqëson interesat e njerëzve lidhur me institucionet shtetërore. Vende të ndryshme kanë disa Avokatë Populli të specializuar për fusha të veçanta. Për shembull, në Hungari, përveç Avokatit të Popullit, ka edhe një tjetër, i cili merret me çështjet që prekin minoritetet etnike dhe një të tretë që merret me çështjet e mbrojtjes së të dhënave dhe informacionit.

Avokati i Popullit heton cënimin e supozuar të të drejtave të qytetarëve prej veprimeve apo mosveprimeve të autoriteteve publike dhe shpreh opinionin e tij lidhur me këto shkelje. Ndonëse opinionin i Avokatit të Popullit nuk është detyrues, në përgjithësi ai është tepër i respektuar.

Institucioni

Avokati i Popullit në Shqipëri caktohet dhe raporton në Kuvendin e Shqipërisë. Institucioni i Avokatit të Popullit është një organ autonom dhe i pavarur që punon në mënyrë të pavarur prej pushtetit ekzekutiv. Avokati i Popullit zgjidhet për një periudhë 5 vjecare me të drejtën për tu rizgjedhur. Kandidatët duhet të kenë njohuri të gjera dhe veprimtari të spikatur në fushën e të drejtave të njeriut; integritet të lartë personal dhe profesional që të zgjidhen në funksionin e Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit mbështetet në punën e tij prej Komisionerëve të zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë me propozim të vetë Avokatit të Popullit.

Detyrat

Avokati i Popullit:

- shqyrton rastet bazuar në kërkesën e dorëzuar nga publiku;
- përgjigjet ankesave që lidhen me punën e gjykatave lidhur me vonesat në procedimin e çështjeve, abuzimin me pushtetin ose dështimin për të zbatuar vendimet e gjykatave;
- shqyrton rastet me nismën e tij / saj;
- depoziton nisma në Kuvend për miratimin e ligjeve, rregulloreve dhe akteve të tjera që janë në përputhje me standartet e pranuar ndërkombëtarisht në fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut;
- nis procedura përpara Gjykatës së Lartë të Shqipërisë; dhe
- trajton çështje të përgjithshme me rëndësi për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, dhe bashkëpunon me organizatat dhe institucionet që merren me të drejtat dhe lirinë e njeriut.

Raportimi dhe pavarësia

Avokati i Popullit dorëzon në Kuvendin e Shqipërisë raportin vjetor që përmban paraqitjen statistikore të rasteve që ka shqyrtuar; një përshkrim të gjendjes lidhur me respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Shqipëri; dhe rekomandime e masa për përmirësimin e të drejtave të njeriut dhe eliminimin e rasteve të shkeljeve të tyre. Një kopje e raportit i dërgohet Presidentit të Republikës dhe Këshillit të Ministrave. Meqë Avokati i Popullit shqyrton veprimet e organeve ekzekutive, është jetësore që vetë institucioni të jetë i pavarur nga organet ekzekutive të qeverisë.

Autoriteti

Avokati i Popullit nuk është një organ juridik. Ndonëse rekomandimet e Avokatit të Popullit përngjajnë shpesh me vendime gjyqësore, ato nuk janë detyruese. Në Shqipëri, Avokati i Popullit ka për detyrë të:

- paraqesë, paralajmërojë, kritikojë, sugjerojë ose rekomandojë;
- sugjerojë që një procedurë e caktuar të zbatohet sipas ligjit në fuqi;
- dorëzojë tek autoriteti kompetent nisma për procedura disiplinore ose procedurën për largimin nga puna të një personi veprimet apo kundërshtimi i të cilit kanë cenuar të drejtat dhe lirinë e njeriut; dhe
- dorëzojë një kërkesë tek Prokurori publik kompetent për të nisur procedurën e përcaktimit të shkallës së përgjegjësisë penale.

TAvokati i Popullit shpreh opinionin e tij nëse, në cilën mënyrë dhe në çfarë mase janë shkelur të drejtat dhe lirinë e njeriut. Nëse ka pasur shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut, opinionin e Avokatit të Popullit duhet të përmbajë edhe rekomandimin se çfarë duhet bërë për të eliminuar shkeljen e këtyre të drejtave dhe afatin kohor brenda të cilit duhet të ndodhë kjo gjë. Personi përgjegjës për organin të cilit i adresohet rekomandimi është i detyruar të paraqesë një raport lidhur me veprimet që janë ndërmarrë për të zbatuar rekomandimin e dhënë brenda afatit kohor të përcaktuar.

Këto opinione dhe vendime respektohen dhe zbatohen në varësi të natyrës së institucionit dhe të statusit të personit që mban atë post. Për më tepër, nëse çështja ka shkuar deri në gjykatë, ka shumë mundësi që gjykata të bëjë gjykimin bazuar në opinionin e dhënë nga Avokati i Popullit.

Adresimi tek Institucioni i Avokatit të Popullit

Procedura për shqyrtimin e një shkeljeve të të drejtave dhe lirive të njeriut fillon mbi bazën e një ankese apo të vetë nismës së Avokatit të Popullit. Ankesat duhen dorëzuar me shkrim ose të depozitohen të rregjistruara.

Depozitimi i një ankese tek Avokati i Popullit nuk kërkohet të bëhet bazuar në ndonjë formular të veçantë, por ankesa / kërkesa duhet të shprehë qartë subjektin e ankesës ose kërkesës. Ankesat apo kërkesat anonime nuk pranohen.

Duhet theksuar se opinionin e Avokatit të Popullit nuk është detyrues për pushtetin ekzekutiv, pra kjo nënkupton që në rastin tonë Ministria e Energjisë dhe Industrisë mund ta refuzojë kërkesën për ti dhënë informacion banorëve të fshatit Bënçë, madje edhe në rastin kur informacioni i kërkuar lidhur me kontratën e koncesionit nuk mund të mbahet sekret.

Nëse personi përgjegjës për menaxhimin e organit përgjegjës nuk vepron pas marrjes së rekomandimit brenda afatit kohor të përcaktuar, Avokati i Popullit mund ta raportojë atë drejtpërsëdrejti tek autoriteti më i lartë, duke dorëzuar një raport apo duke informuar publikun. Ndonëse procedurat e Avokatit të Popullit janë të ngjashme procedurat ligjore, Avokati i Popullit nuk është organ juridik. Për këtë arsye është e mundur që të ngrihet një padi në gjykatë, në të njëjtën kohë me dorëzimin e një ankesë tek Avokati i Popullit.

1.4 Dorëzimi i një kërkesë në Inspektoratin e Mjedisit për kryerjen e një inspektimi

Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve mund të përfshihet në mbrojtjen e të drejtave për mjedisin jashtë proceseve gjyqësore. Inspektorati i Mjedisit kryen inspektimin dhe mbikqyrjen e zbatimit të kuadrit rregullator mjedisor.

Në rastet kur ndeshen shkelje apo moszbatim i normave mjedisore, Inspektorati i Mjedisit vendos gjoba, urdhëron subjektin të korrigojë shkeljet dhe pasojat e vërejtura, si dhe mund të ngrejë një padi penale duke denoncuar në prokurorinë përkatëse të shtetit kundër personit përgjegjës.

Çdokush (pa pasur një interes të shprehur) mund të kërkojë Inspektoratit të Mjedisit të kryejë një inspektim të zbatimit të kërkesave të ligjit (p.sh. të nisë një procedurë inspektimi). Kërkesa mund të jetë edhe anonime.

Nëse shkelja e vërejtur plotëson kushtet e padisë penale sipas Kodit Penal të Shqipërisë, atëherë ajo është kompetencë e Prokurorisë së Shtetit.

Detyrat e prokurorit publik në përmbushje të Nenit 9 të Konventës së Arhusit përfshijnë:

- hetimin e krimeve;
- mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në rastin kur janë kryer kundërvajtje të cilësuar si krim;
- mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të qytetarëve, dhe
- zbatimin e veprimeve parandaluese.

Përfitimet prej përdorimit të institucioneve të Inspektoratit të Mjedisit dhe Prokurorisë së Shtetit

Inspektorati i Mjedisit dhe Prokuroria e Shtetit shqyrtojnë kërkesat e publikut për hetimin lidhur me shkeljet e ligjit. Disa nga përfitimet prej adresimit tek zyrat e Inspektoratit të Mjedisit dhe Prokurorisë së Shtetit përshkruhen në vijim. Sikundërse pjesa më e madhe e ankesave administrative, kërkesa drejtuar Inspektoratit të Mjedisit duhen shqyrtuar brenda një kohe të shkurtër. Për shembull, Inspektorati i Mjedisit duhet të veprojë në përputhje me rregulloret që përshkruajnë inspektimin dhe procedurat administrative. Megjithatë duhet theksuar se pala që dorëzon ankesën/kërkesën nuk është pjesë e procedurës administrative që nis bazuar mbi ankesën/kërkesën e bërë prej saj. Në rastin e Prokurorisë së Shtetit, kur dorëzohet një kallzim penal, prokurori publik duhet të marrë një vendim brenda 15 ditësh nëse do të fillojë ose jo një hetim penal.

Në rastin kur kërkesa dorëzohet në zyrat e Prokurorisë së Shtetit:

- procedurat lidhur me Prokurorinë nuk duhet të kenë asnjë shpenzim;
- nuk është e nevojshme të plotësohen formularë të caktuar, ngjashëm me rastin kur ankimohet ose dorëzohet ankesë lidhur me vendimmarrjen administrative; dhe
- nuk duhet të ketë procedura të gjata prej Prokurorisë së Shtetit për të marrë dokumentacionin i duhur për kallzimin penal.

Cilat janë kompetencat e Inspektoratit të Mjedisit dhe të Prokurorisë së Shtetit?

Gjatë procedurës së inspektimit, për të eliminuar parregullsitë e vërejtura, inspektori është i autorizuar dhe i detyruar të:

- ti paraqesë subjektit të mbikqyrtur parregullsitë e vërejtura dhe të përcaktojë afatet kohore për ndreqjen e tyre;
- të urdhërojë marrjen e masave dhe kryerjen e veprimeve të duhura;
- të ndalojë përkohësisht vijimin e veprimtarive me problematika ose edhe të veprimtarive të tjera;
- të bllokojë përkohësisht objekte dhe asete të lidhura me shkeljen penale të ndodhur;
- të vendosë gjoba;
- të nisë procedurën lidhur me shkeljen; dhe
- të dorëzojë një raport për shkeljen penale ose shkeljet e tjera të vërejtura.

Vendimi për të filluar ose jo procedurën penale merret prej prokurorit kompetent. Në raste të veçanta, kur kanë ndodhur krime të vogla, për të cilat mund të vendosen gjopa të lehta, ndjekja penale mund të kërkohet të fillojë edhe prej palës së dëmtuar (një individ, ose në raste të veçanta prej një organizate, dhome, grupi personash ose organizatash, ose në rastet kur përcaktohet në mënyrë të veçantë prej ligjit). Bazuar në kushtet e ngjarjes së ndodhur, nëse prokurori i shtetit e gjen se nuk ka bazë për të filluar procedurën për hetimin penal, atëherë pala e dëmtuar mund të marrë rolin e prokurorit.

Inspektorët dhe prokurorët janë të detyruar të marrin të gjitha masat e mundshme për të parandaluar ose të ndalin çdo shkelje të mundshme të ligjit. Së fundi, në rast se ka rreziqe të mundshme për jetën dhe shëndetin e individëve, inspektori dhe prokurori duhet të marrin masa për të siguruar sigurinë e tyre.

Dorëzimi i një kërkesë

Mënyra më e mirë për të dorëzuar një kërkesë ose një ankesë në Inspektoratin e Mjedisit dhe Prokurorinë e Shtetit është që ajo të dërgohet me postë të veçantë (postë e rregjistruar). Kjo mënyrë mundëson që dërguesi të marrë konfirmimin për dorëzimin e kërkesës/aplikimit. Raportet/ankesat drejtuar Inspektoratit të Mjedisit mund të dorëzohen edhe me anë të postës elektronike ose telefonit.

Një raportim / ankesë mund të dorëzohet edhe prej vetë individit. Në këtë rast, është mirë që raportimi / ankesa të hartohet në dy kopje, ku njëra prej tyre të mbahet prej aplikuesit, ndonëse nënpunësi që merr kërkesën duhet të japë një numër rregjistrimi dhe datën e marrjes në dorëzim të raportimit në të dy kopjet. Afati kohor i përcaktuar me ligj do të llogaritet prej datës së shkruar në këtë dokument. Prokuroria e Shtetit ka një strukturë hierarkie që duhet ndjekur: kallzimi penal dorëzohet së pari në zyrën e prokurorisë së rrethit.

Cilat janë përfitimet?

Kërkesa për tu shqyrtuar prej Prokurorisë është një hap taktik: në rastin më të keq, ky hap ju mundëson më shumë kohë në dispozicion për tu përgatitur për gjyqin. Megjithatë, ju mund të përballeni me procedura të gjata dhe zyrtarë të prokurorisë tepër të ngarkuar me çështje të tjera.

2. Kush e ka të drejtën të ngrejë një çështje?

Sipas ligjit shqiptar, procedurat e ankimit administrativ duhet të kryhet përpara se dikush ti drejtohet Gjykatës Administrative. Në terma juridikë, kjo referohet si "shterja e mjeteve juridike administrative". Në praktikë, ajo nënkupton që banorët e fshatit Bënçë duhet të ankimojnë tek një autoritet më të lartë (Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informacionit) përpara se sa të dorëzojnë dokumentacionin për të hapur çështjen gjyqësore në Gjykatat Administrative.

Ligjvënësi me qëllim ka vendosur një parakusht të tillë për të shmangur ngarkesën e tepërt në gjykata, të cilat edhe tashmë janë tepër të ngarkuara. Ligji që rregullon një çështje apo vendimmarrje të veçantë përgjithësisht e përcakton nëse një hap i tillë është i domosdoshëm.

2.1 E drejta për të ngritur një çështje nga individët

Kur një çështje i drejtohet gjykatës, ju duhet ti provoni gjykatësit se ju keni interes të ligjshëm për çështjen — dhe që të drejtat tuaja ose interesi i ligjshëm janë cënuar. Ka standarte të ndryshme për çështjet civile dhe ato administrative. Për të përcaktuar se kërkesa juaj është e bazuar, ju duhet të verifikoni nëse padia plotëson njërin prej kërkesave të përshkruara më poshtë.

E drejta për t'ju drejtuar gjykatës lidhur me marrjen e informacionit

(Konventa e Arhusit, Neni 9.1)

Ky është rasti më i thjeshtë. Është e mjaftueshme të provoni që ju keni kërkuar informacion dhe keni marrë një përgjigje, e cila sipas opinionit tuaj nuk është e kënaqshme, ose nuk është plotësisht e kënaqshme; apo nuk ju është kthyer fare përgjigje.

E drejta për t'ju drejtuar gjykatës lidhur me pjesëmarrjen e publikut

(Konventa e Arhusit, Neni 9.2)

Meqenëse cilësimi "publik i prekur" është parakusht për pjesëmarrjen në procese specifike ose vendimmarrje strategjike, ju duhet të provoni që jeni prekur nga vendimi dhe duhet të përshkruani se si jeni prekur (p.sh. ju jeni banor i një zone të caktuar për të cilën është dhënë leje ndërtimi ose në të cilën do të zbatohet një plan i dhënë). Juve nuk ju duhet të provoni që procedura është shkelur në ndonjë formë apo mënyrë: këtë gjë do ta vendosë gjykata gjatë marrjes së vendimit.

Zbatimi i ligjit të mjedisit

Ndoshta kjo është çështja më e vështirë për tu provuar. Shumica e vendeve nuk e njohin të drejtën e një individi ose të një personi juridik për të çuar në gjyq çështje që nuk i prekin ata individualisht, por që kanë të bëjnë me shumë me përpjekjen për të parandaluar shkeljen e legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit. Rruga më e zakonshme, siç u diskutua më sipër, do të ishte përpjekja për ta trajtuar çështjen duke e sjellë atë në vëmendjen e Inspektoratit të Mjedisit ose të Prokurorisë. Megjithatë Neni 9.3 i Konventës së Arhusit paraqet një sërë mundësish për të ngritur një çështje lidhur me rastet e zbatimit të ligjit. Praktika tregon se gjykatat në disa vende kanë marrë vendime ku çdo individ ka interes për mbrojtjen e mjedisit, duke ju referuar të drejtës kushtetuese për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe në detyrimin për mbrojtjen e mjedisit.

E drejta për t'ju drejtuar gjykatës për të mbrojtur të drejtat për mjedisin ose ato civile të një individi

Në procedurat civile, çdo individ apo organizatë mund të kërkojë shpërblim për dëmtime të shkaktuara nga rrezikimi i të drejtave për mjedisin, sikundërse mund të ngrejë një padi për të parandaluar ngjarje që shkaktojnë dëmtimin e mjedisit, për të cilat qëllimi është ti kërkojë gjykatës të urdhërojë masat sigurie të përkohshme gjatë procesit të shqyrtimit të padisë. Për rastet që trajtohen nën ligjin e të drejtës civile, kërkohet të paditësi të paraqesë prova që shëndeti, prona dhe të drejta të tjera materiale janë ndikuar prej veprimtarisë së të pandehurit.

Ka edhe raste ku kërkohet kompensimi apo rikthimi në gjendjen e mëparshme (p.sh. në rastin kur shkarkimet e gazeve të një fabrike kanë tejkaluar kufirin e lejuar për të shkaktuar ndikime negative në shëndet dhe kanë sjellë shpenzime shtesë për kujdesin shëndetësor).

2.2 E drejta për të ngritur një çështje nga OJFtë

Neni 9.2 i Konventës së Arhusit jep një vend të veçantë OJFve lidhur me të drejtën për t'ju drejtuar gjykatës lidhur me pjesëmarrjen e publikut. Sipas parashikimeve në këtë nen, çdo OJF njihet si "publik interesuar" dhe që ka interes të mjaftueshëm për çështjen (pavarësisht nëse ka ose jo interes të drejtpërdrejtë ose nëse janë prekur ose jo interesat e drejtpërdrejta të vetë OJF-së apo të anëtarëve të saj), në rastet kur plotësohen kriteret e mëposhtme:

PRACTICAL TIP

To be entered in the NGO Register, an organisation must file an application with Tirana District Court and submit the following documents:

- articles of incorporation;
- minutes of the founders' assembly; and
- the organisation's statutes;
- the organisation's programme.

All documents and the application that is submitted to Tirana District Court need to be certified by a notary.



1. OJFja njihet si person juridik sipas legjislacionit në fuqi të vendit (p.sh. është e rregjistruar si shoqatë jo fitimprurëse ose fondacion joqeveritar). Konventa nuk kërkon që OJFja të jetë e rregjistruar zyrtarisht në mënyrë që të çojë një çështje përpara gjykatës dhe të njihet si "publik i prekur". Ajo i referohet kuadrin ligjor vendas për të përcaktuar se çfarë konsiderohet një OJF. Sipas Ligjit për Organizatat Jofitimprurëse në Shqipëri, OJFtë duhet të jenë të rregjistruara në regjistrin kombëtar që gjendet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në varësi të formës ligjore (qendër, shoqatë apo fondacion), OJFja mund të ngrihet prej një ose më shumë personave fizikë ose juridikë. Pas rregjistrimit, OJF-së i jepet dokumenti zyrtar i rregjistrimit (një Vendim Gjykate për rregjistrimin e OJF-së në regjistrin e organizatave joqeveritare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë), dokumenti rregjistrimit në zyrën e taksave (i lëshuar prej Drejtorisë Rajonale të Taksës ku gjendet selia e OJF-së), vula dhe personaliteti juridik.
2. OJF e ka mbrojtjen e mjedisit një ndër qëllimet e saj — për shembull mbrojtja e mjedisit është e shkruar si një ndër qëllimet në statutin e organizatës.

Depozitimi i një kopjeje të statutit të organizatës dhe vendimit të rregjistrimit në gjykatë janë të mjaftueshme për të provuar të drejtën për të ngritur një çështje të pjesëmarrjes në vendimmarrjen për mjedisin. Megjithatë, mund të sillen argumenta se edhe në rastet kur nuk është shkruar mbrojtja e mjedisit në dokumentet e rregjistrimit të organizatës, vetë aktiviteti i organizatës në fusha të caktuara të mjedisit duhet të jetë i mjaftueshëm për të plotësuar kriteret e kërkuara më sipër.

3. Si ti drejtohem gjykatës

Rregullat se kush mund të kundërshtojë një vendim dhe rruga që duhet ndjekur janë të përcaktuara në kodin e procedurave. Nëse është nevoja për më shumë informacionin se si mund të dërgohet një çështje në gjykatë duhen konsultuar Ligji për Gjykatat Administrative dhe Zgjidhjen e Mosmarrveshjeve Administrative. Ky kapitull jep udhëzime praktike rreth dërgimit të një çështjeje në gjykatë dhe përshkruan disa prej hapave të procedurës që duhet ndjekur.

3.1 Teknikat për të ngritur padinë

CNdryshe nga mendimi i përgjithshëm, dërgimi i një çështjeje në gjykatë nuk është domosdoshmërisht një ndërmarrje tepër e vështirë, rraskapitëse dhe e pashpresë. Rastet e bazuara në çështje administrative të tilla si e drejta për informimin apo shkëlja e procedurave lidhur me kërkesat për pjesëmarrjen e publikut, në shumicën e rasteve, nuk janë të ndërlikuara. Për më tepër, në shumë raste është mjaft e lehtë të provohet shkëlja e procedurave.

Sapo ju apo përfaqësuesi juaj të keni hartuar padinë, ajo duhet të dërgohet në gjykatë. Përveç pagesës së tarifave gjyqësore (shih 3.4), ka edhe disa kërkesa të tjera për dorëzimin e dokumentacionit. Së pari, duhet të verifikoni nëse kodi i procedurave apo ligje të tjera që rregullojnë një proces të veçantë kërkojnë që ju të keni shterruar më parë rrugët administrative (shih 1.1).

Hartimi i dokumentacionit për padinë

Përfshirja e një juristi profesionist është ndihmuese për të mbledhur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe për të vlerësuar të gjithë rrethanat lehtësuese dhe provat. Ndonëse avokatët privatë janë mjaft të shtrenjtë; ka edhe avokatë mjedisore ose avokatë pro bono që mund ta trajtojnë rastin tuaj pa pagesë.

Dokumentacioni i padisë duhet të përmbajë:

- Emrin e gjykatës kur depozitohet padia;
- Emrin, emrin e babait, mbiemrin, adresën e përhershme apo vendbanimin e paditësit dhe të palës së paditur dhe të personave që i përfaqësojnë ata, nëse ka të tillë. Nëse paditësi apo i padituri janë persona juridikë, emri duhet të përputhet me atë të regjistrimit në regjistrat publikë, duke treguar selinë ose zyrat qendrore ku do të dërgohet njoftimi;
- Subjekti i mosmarrveshjes;
- Kërkesat lidhur me pretendimin kryesor dhe pretendimet e tjera;
- Një përshkrim të fakteve konkrete, rrethanave, dokumentave dhe provave të tjera, mbi të cilat ngrihet padia; si edhe pretendimi kryesor i paditësit;
- Vlera e padisë, nëse subjekti i padisë është i llogaritshëm;

- Firma e paditësit (në rastin e një personi juridik siç është një OJF, dokumenti duhet firmosur prej autoritetit kompetent menaxhues dhe duhet vulosur); dhe
- Datën e dorëzimit.

Shprehuni thjesht dhe qartë

Nëse vendosni ta përgatisni vetë dokumentacionin, është e rëndësishme të mbani parasysh se gjykatat janë tepër të ngarkuara me raste dhe gjykatësit janë çdo ditë të ngarkuar me ankesa dhe padi.

Një listë e plotë e fakteve, datave dhe emrave, referime lehtësisht të përdorshme për të gjithë dokumentacionin e rastit dhe lista e shtojcave e renditur saktë do të jenë më të dobishme për ju dhe gjykatësin sesa përdorimi i një gjuhë të ndërlikuar ligjore. Shprehuni dhe organizoni gjërat qartë dhe thjesht dhe përpiquni të keni sa më shumë referime të jetë e mundur të parashikimeve në kuadrin ligjor që mbështet rastin tuaj.

Praktika juridike, qëndrimet ligjore dhe rastet e trajtuara në gjykatat ndërkombëtare janë një ndihmë e madhe për gjykatën. Gjykatësi ka një deri në dy javë kohë për të vendosur nëse rasti juaj pranohet dhe vendos datën për dëgjimin e palëve. Është e kuptueshme që të gjitha përshtypjet e para të rëndësishme për rastin dhe palët e përfshira krijohen bazuar në dokumentacionin e dorëzuar prej jush.

Dorëzoni kopje të mjaftueshme

Së bashku me dosjen e dokumentacionit në original duhet dorëzuar edhe nga një kopje për secilën palë të paditur në këtë çështje.

Ka gjithnjë një shanc të dytë

Nëse dokumentacioni nuk është i plotë ose është i pasaktë, apo nëse nuk është kryer pagesa e shpenzimeve të gjyqit (3.4), gjykatësi mund ta ndërpresë procedurën dhe të informojë paditësin rreth mangësive në dokumentacion duke i dhënë një afat të ri kohor për të dorëzuar dokumentacionin e plotë.

3.2 Në cilën gjykatë duhet të shkoj?

Në Shqipëri, paditë administrative paraqiten në Gjykatat Administrative. Siç u paraqit më lart, ka gjashtë Gjykata Administrative të Shkallës së Parë dhe një Gjykatë Administrative të Apelit në Tiranë. Procedurat e Gjykatës Administrative janë procedura më të thjeshtëzuar krahasuar me ato civile meqë çështjet e mosmarrveshjeve administrative janë përgjithësisht më të thjeshta për të marrë vendim dhe nuk kërkojnë shumë prova apo debat të gjatë ndërmjet palëve ndërgjyqëse (përveç rasteve kur kërkohet raport ekspertize prej një eksperti të fushës).

Padia duhet dorëzuar brenda 45 ditëve nga dërgimi tek pala e interesuar e aktit administrativ. Në rastin tonë banorët e fshatit Bënçë duhet të dorëzojnë padinë në Gjykatën Administrative Tiranë nëse vendimi i marrë në shkallën e dytë për ankesën administrative nuk është i pëlqyeshëm, ose nëse nuk është marrë ndonjë përgjigje brenda afatit kohor të përcaktuar (15 ditë nga data e dorëzimit të ankimit).

Sipas procedurës administrative gjykatat janë:

- Gjykata Administrative të Shkallës së Parë (në Tiranë, Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë);
- Gjykata Administrative e Apelit në Tiranë;
- Dhoma administrative e specializuar në Gjykatën e Lartë, e cila është gjykata më e lartë në Shqipëri, që ka të drejtën për të vendosur për rastet që paraqiten me shkelje të rënda të ligjit material ose procedural. (Kërkesa për shqyrtimin e vendimit gjyqësor mund të dorëzohet në këtë gjykatë kundër vendimit përfundimtar të Gjykatës Administrative.)


Së fundi, Gjykata Kushtetuese mund të shqyrtojë çështje të parashtruara si ankimit kushtetues lidhur me shkeljen e të drejtave dhe lirive të njeriut pasi janë shterrur të gjitha rrugët e tjera të përcaktuara me ligj. Sipas Kushtetutës së Shqipërisë, Gjykata Kushtetuese anulon ose tërheq çdo ligj që nuk është në përputhje me Kushtetutën, ose anulon ose tërheq akte të tjera normative që nuk janë në përputhje me Kushtetutën apo marrveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të zbatueshme.

Kushtetuta përcakton dy kategori të ndryshme: (a) subjekte që mund të kundërshtojnë çdo ligj duke ju drejtuar Gjykatës Kushtetuese (kjo kategori përfshin Presidentin e Republikës, Kryeministrin, jo më pak se një të pestën e anëtarëve të Kuvendit dhe Avokatin e Popullit) dhe (b) subjekte që mund të kundërshtojnë një ligj vetëm nëse interesat e tyre janë të prekura drejtpërdrejt (në këtë kategori përfshihen subjektet e mëposhtme:

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit; çdo gjykatë; çdo komisioner i zgjedhur sipas ligjit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë; Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë; Njësitë e qeverisjes vendore; Forumet e komuniteteve fetare; Partitë politike; Organizatat dhe Individët.) Kërkesa duhet strukturuar mirë, të jetë e argumentuar, e plotë në formë dhe përmbajtje — e cila përmban informacionin për aktin që kundërshtohet, faktet dhe arsyet mbi të cilat bazohet dëshmia se është shkelur ligji kushtetues, si edhe një identifikim i qartë dhe firma e personit që dorëzon kërkesën.

Vendimi i Gjykatës mund të anulohet ligjet ose aktet e tjera ligjore të përgjithshme. Pas dhënies së vendimit për abrogimin, ligji ose rregulloret ose aktet ligjore të përgjithshme pushojnë së vepruari nga momenti kur ky vendim botohet. Në anën tjetër, pas vendimit për të anuluar, Gjykata Kushtetuese anulon jo vetëm aktin, por edhe të gjitha pasojat e rrjedhura prej zbatimit praktik të tij deri në momentin e marrjes së vendimit.

Figure 2. Sistemi i gjykatave në procedurën administrative



Juridiksioni territorial

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka juridiksion territorial në rajonet e mëposhtme:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka juridiksion territorial mbi rrethet e mëposhtme: Bulqizë, Dibër, Krujë, Laç, Mat dhe Tiranë dhe gjendet në Tiranë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës ka juridiksion territorial mbi rrethet e mëposhtme: Elbasan, Gramsh, Librazhd, Peqin, Durrës dhe Kavajë dhe gjendet në Durrës.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër ka juridiksion territorial mbi rrethet e mëposhtme: Lezhë, Mirditë, Kukës, Has, Pukë, Malësi e Madhe, Shkodër dhe Tropojë dhe gjendet në Shkodër.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka juridiksion territorial mbi rrethet e mëposhtme: Berat, Skrapar, Kuçovë, Fier, Mallakastër, Lushnjë dhe Vlorë dhe gjendet në Vlorë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë ka juridiksion territorial mbi rrethet e mëposhtme: Devoll, Kolonjë, Bashkinë Leskovik, Korçë dhe Pogradec dhe gjendet në Korçë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë ka juridiksion territorial mbi rrethet e mëposhtme: Gjirokastrë, Tepelenë, Përmet, Delvinë dhe Sarandë dhe gjendet në Gjirokastrë.

Gjykata Administrative e Apelit që gjendet në Tiranë ka juridiksion territorial në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Vendimi përfundimtar i Gjykatës Administrative të Apelit mund të apelohej duke përdorur mjete të posaçme vetëm në Gjykatën e Lartë.

3.3 Afatet kohore

Afati i fundit përlllogaritet nga data kur paditësi është njoftuar dhe i është dorëzuar vendimi që e informon atë se apeli i tij është refuzuar (shih shembullin më poshtë). Ligji për Gjykatat Administrative dhe Zgjidhjen e Mosmarrveshjeve Administrative në Shqipëri përcakton një periudhë 45 ditore gjatë së cilës njëra palë mund të depozitojë një padi kundër një akti administrativ (shih skemën më poshtë). Megjithatë, pretendimet civile të lidhura me çështjen për dëme të shkaktuara nga ligji mund të depozitohen në gjykatën civile brenda një periudhe tre vjeçare.

3.4 Kostot e gjyqit

Kur vendosni nëse do të shkoni në gjyq, është e rëndësishme të bëni një vlerësim sa mund të kushtojë ky proces. Shumica e rasteve të trajtuara në kuadër të Konventës së Arhusit nuk janë shumë të kushtueshme, ndërkohë që rastet kur pretendohen dëme të mëdha këto kosto mund të jenë një pengesë e madhe.



FOR EXAMPLE

Afatet kohore të ankimimeve/ padive administrative në praktikë

Banorëve të fshatit Bënçë ju refuzua informacioni i kërkuar në kërkesën e tyre drejtuar Ministrisë. Ligji për të drejtën e informimit përcakton një afat 30 ditor për dorëzimin e ankesës tek Komisioneri, periudhë e cila fillon nga dita e marrjes së përgjigjes për refuzimin e kërkesës së tyre. Megjithatë, nëse ankimimi depozitohet tek një autoritet i një shkalle më të lartë (shkallë e dytë) dhe ky ankimin është refuzuar, atëherë ata kanë të drejtë të depozitojnë brenda 45 ditëve një padi në Gjykatën Administrative Tiranë.

Tabela 1. Shpenzimet e gjyqit

Shpenzim	Rëndësia e rasteve
Lloji i kostove	Rastet kur zbatohen
Tarifa gjyqësore	Për të gjitha paditë
Kostot për ekspertin	Vetëm për ligjin penal
Kostot e hetimit	Përcaktohen nga faji; e drejta materiale
Kostot për sjelljen e dëshmitarëve	Përcaktohen nga faji dhe të tjera

Llogaritja e tarifës gjyqësore

Kostot për apelimin kundër vendimeve ose dështimit për të vepruar prej autoriteteve publike (e drejta për informacion, shkelje procedurale lidhur me dispozitat për pjesëmarrjen publike, etj), dhe depozitimi i ankesave administrative tek një autoritet i shkallës së dytë janë pa pagesë. Shqipëria është në procesin e rishikimit të tarifave gjyqësore pas miratimit të ligjit të ri për tarifën gjyqësore.

Megjithatë, me ngritjen e padisë, depozitimi i padisë administrative për vlera deri në 100.000 Lekë është 3.000 Lekë dhe për vlera mbi këtë shumë, tarifa është 1% e vlerës së kërkuar.

Përfshirja prej tarifave

Ligji për ndihmën ligjore të garantuar nga shteti përcakton se cilat kategori të paditësve dhe cilat lloje të mosmarrveshjeve përjashtohen nga pagesa e tarifave. Gjykata mund të përjashtojë një person nga pagesa e tarifës nëse klasifikohet në kategoritë me nevojë të veçanta (viktima të dhunës në familje, viktima të abuzimit seksual ose viktima të krimeve të trafikimit, të miturit nën përgjegjësinë e shërbimeve të kujdesit social, personat që përfitojnë nga skemat e mbrojtjes sociale etj) ose nëse nuk kanë të ardhura dhe mjete të mjaftueshme.

Koha e pagesës dhe detyrimet e palës humbëse

Rregulli bazë në procedurën civile është që çdo palë të mbajë kostot e veprimeve të saj paraprakisht, dhe që pala që paraqet provat duhet që, sipas urdhërit gjyqësor, të paguajë paraprakisht shumën e domosdoshme për të mbuluar shpenzimet për paraqitjen e provave. Pala që humbet në gjykatë është e detyruar të kompensojë palën kundërshtare dhe përfaqësuesin e saj ligjor.

3.5 A është rasti i pranueshëm?


Gjykatësi kryesues, gjatë veprimeve paraprake, vendos nëse ankesa është jo e plotë ose e pakuptueshme. Në këtë rast Gjykata Administrative do të ftojë paditësin të plotësojë mungesat e vërejtura brenda një afati kohor të dhënë dhe do ti paraqesë pasojat e moskryerjes së një detyrimi të tillë. Paditësi do të marrë udhëzimet se çfarë duhet të bëjë dhe si duhet të veprojë. Nëse paditësi nuk plotëson mungesat e vërejtura në dosjen e ankimit brenda afatit kohor të përcaktuar, dhe këto mangësi janë të tilla që e pengojnë punën e Gjykatës Administrative, gjyqi mund ta pushojë çështjen duke e konsideruar si të pavlefshme.

3.6 Përgatitja për dëgjimin e palëve

Siç u shpjegua më lart, gjykatat e shkallës së parë e kryejnë gjykimin mbi bazën e dëgjimit të palëve. Fillimisht, brenda 7 ditëve pas dorëzimit të padisë, gjyqtari kryesues merr një sërë veprimesh përgatitore që përfshijnë: njoftimin e palës së paditur rreth padisë dhe gjithë akteve të lidhura me të; vendos një afat kohor brenda 10 ditëve që pala e paditur të dorëzojë gjithë argumentat me shkrim, listën e personave që

pala e paditur kërkon të sillen në gjyq në cilësinë e dëshmitarëve ose të ekspertëve dhe adresat e tyre, si dhe të gjitha aktet e shkruara mbi të cilat bazohet veprimi i aktit administrativ dhe do të kryhet shqyrtimi i ankimit administrativ. Në rastet kur kërkohen njohuritë e një eksperti, gjyqtari merr vendimin për të caktuar një ekspert, i cili duhet të japë mendimin e tij. Pasi kanë përfunduar të gjitha veprimet përgatitore, gjyqtari kryesues lëshon urdhërin që përmban datën dhe kohën e dëgjimit të palëve. Afati kohor për dëgjimin e palëve nuk duhet të jetë më tepër se 15 ditë. Dëgjimi i palëve fillon me gjykatësin, i cili paraqet emrin e tij dhe të gjykatës që gjykon çështjen dhe i pyet palët ndërgjyqëse nëse kanë ndonjë kërkesë paraprake (kërkesat lidhur me kompetencën dhe juridiksionin e gjyqit, moskualifikimin e gjyqtarit etj) dhe pas kësaj fton paditësin të paraqesë ankesën e tij. Ftohen për të folur përfaqësuesi i autoritetit publik përgjegjës dhe i palëve të interesuara, nëse ka të tilla. Gjykatësi vendos për çështjen mbi bazën e fakteve të paraqitura gjatë dëgjimit të palëve ndërgjyqëse dhe të provave të sjella prej tyre.

Figure 3. Hapat pas dorëzimit të padisë administrative



Gjykata Administrative e jep vendimin të arsyetuar në formë të shkruar. Palëve u jepet nga një kopje certifikuar e vendimit gjyqësor.

Si rregull, çdo vendim gjyqësor duhet të publikohet në faqen e internetit, në një formë anonime në faqen e internetit www.gjykata.gov.al. Megjithatë faqja e internetit nuk rifreskohet rregullisht dhe disa herë vendimet nuk gjenden të shpallura në të.

Shembuj të mirë të transparencës janë faqet e internetit të gjykatave të Rrethit Gjyqësor Tiranë (<http://www.gjykatatirana.gov.al/>), Gjykata e Apelit Tiranë (<http://www.gjykataeapelittirane.al/>), Gjykata Administrative e Apelit (<http://www.gjykataadministrativeeapelit.al/>) dhe Gjykata e Lartë (<http://www.gjykataelarte.gov.al/>) ku vendimet gjyqësore publikohen rregullisht në internet.

Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë mund të apelohej në Gjykatën Administrative të Apelit në Tiranë. Megjithatë duhet theksuar se jo çdo vendim mund të apelohej. Aktet ose veprat administrative me vlerë më të vogël se njëzet fishi i pagës minimale nuk shqyrtohen prej Gjykatës Administrative të Apelit.

Si rregull Gjykata Administrative e Apelit vendos në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve. Megjithatë, dëgjimi i palëve me praninë e palëve mund të mbahet në rastet e mëposhtme:

- Kur duhen verifikuar faktet dhe provat e reja të grumbulluara për të njohur gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë;
- Kur vendimi kundër të cilit është kryer apelimi është marrë një shkelje të rëndë të procedurave ose është bazuar në gjendje faktike të gabuar ose në mënyrë jo të plotë;
- Kur gjendja faktike është e saktë, por duhet përsëritur marrja e një pjese të provave apo e të gjithë provave prej gjykatës së shkallës së parë

Rekursi kundër vendimit përfundimtar të Gjykatës Administrative dhe kërkesa për rihapjen e shqyrtimit duhet depozituar kundër vendimit përfundimtar të Gjykatës Administrative. Gjykata e Lartë e Shqipërisë vendos për rekursin, ndërsa Gjykatat Administrative vendosin për rihapjen e shqyrtimit.

Ekziston mundësia që Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë të fillojë shqyrtimin e një ankese kushtetuese për shkeljen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi janë shterrur të gjitha rrugët e tjera ligjore.

3.7. Teknika të tjera të dobishme

Veprimi i grupuar

Një çështje mund të jetë shumë më e fortë nëse paditësi nuk është një individ apo organizatë e dëmtuar, por një grup qytetarësh të cënuar prej një vendimi, të cilët janë grupuar së bashku për të bërë padinë.

Për shembull, padia kundër ndërtimit të një hidrocentrali është nënshkruar prej 37 banorëve të fshatit Kute në Mallakastër, një organizatë jofitimprurëse vendore dhe dy organizata jofitimprurëse ndërkombëtare. Padia është lidhur me cënimin e të drejtës për marrjen e informacionit dhe pjesëmarrjen e publikut gjatë procedurës së kryerjes së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për këtë vepër energjetike. Padia ishte e suksesshme dhe gjyqi vendosi të anulohet dhe shpallë të pavlefshme lejen mjedisore të lëshuar bazuar në dokumentin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe të gjithë aktet pasuese bazuar në lejen mjedisore të lëshuar, përfshirë edhe kontratën e koncesionit.

Përdorimi i precedentëve

Kur merrret vendimi, gjykata bazohet në provat materiale dhe kur lind nevoja edhe në logjikën mbi çështjen. Në ditët e sotme, vëmendje e veçantë i kushtohet vendimeve të mëparshme të marra nga gjykata të tjera, veçanërisht në vendimmarrjen e atyre gjykatave që janë më lart në hierarkinë e sistemit gjyqësor.

Gjykata e Lartë e Shqipërisë mban qëndrim ligjor në parim për çështje të diskutueshme ligjore që paraqiten në praktikën gjyqësore me qëllim që të sigurohet zbatimi uniform i ligjeve prej të gjitha gjykatave. Gjykata përvetëson këto vendime në dhomat e përbashkëta (me pjesëmarrjen e të gjithë gjykatësve të Gjykatës së Lartë). Këto gjykime janë detyruese për gjykatat e niveleve më të ulta për rastet e ardhshme dhe përbëjnë material referimi për gjyqtarët e gjykatave të niveleve më të ulta, të cilat konsultohen me këto vendime kur duhet të vendosin për rastet.

Detyra kryesore e Gjykatës Kushtetuese është të interpretojë dispozitat ligjore dhe përcaktojë nëse ligje dhe rregullore të veçanta bien në kundërshtim me Kushtetutën. Këto interpretime përdoren më pas prej gjykatave të tjera.

Është e rëndësishme të bëhet krahasimi me raste të mëparshme: përmendja e precedentëve do ta bëjë padinë tuaj më të fortë. Rastet në gjykatat më të larta mund të jenë të dobishme, por nuk përmenden zyrtarisht prej gjykatës në vendimet që ai merr.

Vendimet dhe interpretimet e Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese mund të shërbejnë si referim zyrtar për vendimet e gjykatave më të ulta.

3.8 CBllokimi i veprimtarisë gjatë marrjes së një vendimi (urdhër i përkohshëm pezullimi)

Mbrojtja administrative-juridike nënkupton mundësinë që Gjykata Administrative, gjatë shqyrtimit të një mosmarrveshjeje administrative, të urdhërojë masa të përkohshme për të rregulluar një situatë të caktuar deri në marrjen e vendimit prej gjykatës. Urdhri i përkohshëm i pezullimit është shumë i rëndësishëm në çështjet mjedisore, veçanërisht në rastet kur kundërshtohet leja e ndërtimit të një fabrike. Një gjykatës nxjerr urdhrin e përkohshëm të pezullimit me kërkesën e paditësit. Në rastet e çështjeve mjedisore që dërgohen në gjykatë, kjo është një masë e përkohshme që bllokton një veprim, në mënyrë që të sigurohet se vendimi i ardhshëm i gjykatës është i zbatueshëm.

3.9 Si të kërkohet ndihmë (avokacia për interesin publik)

Sipas Ligjit për Ndhimën Ligjore të Garrantuar nga Shteti, një individ që plotëson kushtet e përcaktuara ka të drejtën të marrë ndihmë ligjore falas nga një jurist i caktuar nga dhoma e avokatëve, mbi bazë rotacioni. Ndhimja ligjore falas nënkupton dhënien e fondeve të nevojshme për mbuluar tërësisht ose pjesërisht kostot për këshillimin ligjor, hartimin e letrave, përfaqësimin në seancat përpara gjyqit, në zyrat e Prokurorisë dhe të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë dhe në procedurat për zgjidhjen e mosmarrveshjeve jashtë dhomës së gjyqit, si dhe përjashtim prej kostove të procedurave gjyqësore. Fondet për ndihmën ligjore falas jepen nga Buxheti i Shtetit.

Kushtet që duhen plotësuar për të përfituar ndihmën ligjore falas përshkruhen në Nenet 10, 11 dhe 12 të Ligjit për Ndhimën Ligjore Falas. Në çështjet mjedisore, zbatohet vetëm paragrafi, i cili përshkruan personat me të ardhura të pakta financiare (Neni 12).

Përfitimi i të drejtës për ndihmë ligjore falas sipas këtij ligji nuk kufizon dhënien e mbështetjes ligjore prej shërbim-ofruesve të ndryshëm, OJFve dhe organizatave të tjera që veprojnë sipas ligjit në fuqi.

3.10 Përfshirja e ekspertëve

Rastet që ngrihen mbi bazën e pretendimit në thelb (shkelja e të drejtave bazë që përfshijnë të drejtën për një mjedis të pastër, të drejtat e pronësisë, kompensimin e dëmit dhe të drejtat e tjera) shpesh kërkojnë parashtrimin e provave dhe mendimin e ekspertëve. Edhe në rastet kur kundërshtoni një vendim bazuar në trajtimin e pakënaqshëm të komenteve tuaja, shpesh herë ju duhet mendimi i ekspertëve. Kodi i Procedurave Administrative dhe Ligji i Gjykatave Administrative dhe i Zgjidhjes së Mosmarrveshjeve Administrative në Shqipëri e njeh konceptin e ndihmës së ekspertëve. Në procedurën administrative që kërkon njohuri profesionale lidhur me çështjet procedurale, një palë mund të sjellë një ekspert për të dhënë shpjegime dhe këshilla. Personi që jep ndihmë si ekspert nuk përfaqëson ndonjërin nga palët ndërgjyqëse dhe duhet të jetë qartësisht i paanshëm prej secilës palë. Eksperti mban vetëm qëndrim bazuar në fakte dhe nuk ka të drejtë të ndër marrë ndonjë veprim ligjor në emër të ndonjërit prej palëve siç merr juristi.

Ku mund të gjendet eksperti

Si mund të gjendet eksperti i duhur në fushën e ekspertizës që kemi nevojë? Shumë ekspertë teknikienë janë të angazhuar në lëvizjen mjedisore, ndaj mund të kontaktohen ose mund të përfshihen përmes OJFve të tyre. Shumë prej këtyre ekspertëve mund ta mbështesin çështjen tuaj pro bono, ose kundrejt një tarife për kohën e tyre. Një vend tjetër ku mund të kërkoni për ekspertë janë universitetet dhe institutet e kërkimit shkencor, të cilat kanë ekspertizën dhe kapacitetet teknike. Së fundi, ju mund të vlerësoni edhe mundësinë e përfshirjes së një eksperti privat. Është e rëndësishme që ekspertët tuaj të kenë kredenciale të mira. Disa here, ky fakt është më i rëndësishëm sesa vetë mendimi që ata do të japin.

Udhëzime të tjera

Ndonëse dërgimi i një çështje në gjyq shpesh mundëson zgjidhjen e e problemit, shpesh është më e shpejtë dhe më e lirë të ankimoni tek autoritetet më të larta. Në të njëjtën kohë, megjithëse apelimet administrative janë zgjidhje më e shpejtë, zgjidhja e çështjes në gjykatë i jep vlerë çështjes përtej rastit tuaj, meqenëse vendimi gjyqësor vendos një precedent. Kurdoherë është e rëndësishme të rregjistroni çfarë keni komunikuar me autoritetet përkatëse dhe grupet e interesuara. Kur do të paraqesni komentet apo kërkesën për informacion, sigurohuni që keni prova për komunikimin tuaj (prova lidhur me postimin, rregjistrime, dhe komunikime zyrtare me anë të postës elektronike, etj.). Shmagnit komunikimet jozyrtare dhe ato me gojë. Shënimet e duhura do të mbështetin kërkesën tuaj dhe do të shërbejnë si prova në procedurën ligjore.

4. Paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike

Ndërsa publiku, individët dhe OJFtë mund të ngrenë padi ndaj autoriteteve publike dhe kompanive private dhe shtetërore për shkeljen e të drejtës për të marrë pjesë dhe shkelje të ligjit për mjedisin, disaherë kompanitë private dhe autoritetet mund të përdorin gjykatat për të parandaluar pjesëmarrjen aktive.

Si shembull i kësaj praktike është rasti e znj. C.B., një shtetase e SHBASë që jeton në Luginën e Valbonës në Tropojë, e cila ka kundërshtuar publikisht ndërtimin e hidrocentraleve në Luginën e Valbonës. (Lugina e Valbonës është Park Kombëtar me mundësi të mëdha për zhvillimin e turizmit). Ajo organizoi dhe morri pjesë në protestat dhe veprimtari të tjera, në Valbonë dhe Tiranë, për rritur mbështetjen e komuniteteve vendore. Kompania që po ndërton hidrocentralet e hodhi në gjyq Znj. C.B. për shpifje dhe kërkoi 20 milionë Lekë si dëmshpërblim në padinë e ngritur. Qëllimi i këtyre padive nuk është mirëfilli marrja e kompensimit, por:

- a) duke e ngarkuar këtë anëtar të komunitetit të përfshirë në procesin e pjesëmarrjes së publikut me procedura juridike të gjata dhe të ndërlikuara, synon të tërheqë vëmendjen prej vendimmarrjes në të cilën ky anëtar ka marrë pjesë dhe ka ndikuar; ose
- b) duke krijuar një atmosferë frike se po të flasë apo kundërshtojë një vendim apo një propozim mund të dërgohet në gjyq, pjesëtarët e tjerë të komunitetit do të mendohen dy herë për tu përfshirë në këtë proces apo në proceset e ardhshme pjesëmarrëse.

5. Pengesat për t'ju drejtuar gjykatës

Ndonëse dërgimi i një çështje në gjyq nuk është aq e frikshme ose e vështirë sa e mendojnë shumica e njerëzve, ka disa pengesa që mund ta komplikojnë procesin juridik dhe të pengojnë të drejtën për t'ju drejtuar gjykatës.

Dy problemet kryesore janë mungesa e pavarësisë juridike dhe mungesa e besimit në sistemin gjyqësor. Te dyja janë të varura nga njëra tjetra. E para ka të bëjë me nivelin institucional, dhe ndonëse është një problem i pranishëm, shpesh ai është i mbi theksuar. Problemi i dytë është i rrezikshëm. Nëse krahasojnë numrin e gjykatësve që kanë dëshirën e mirë me numrin e qytetarëve që i drejtohen gjykatës mendjehapur, të parët mund të jenë më të shumtë në numër.

E vetmja rrugë për tu përballur me këto probleme është ta dërgosh çështjen në gjyq, dhe në këtë mënyrë të edukohen gjyqtarët në fushën e mjedisit dhe të krijohen precedentët e duhur.

Pengesa të tjera vërehen më shumë në nivelin praktik, siç gjenden të renditura më poshtë.

5.1 Kundër paditë

Gjatë ecurisë së gjyqit, shpesh sulmi është forma më e mirë e mbrojtjes. Nuk është për tu habitur që kundër paditë ndeshen edhe në çështjet mjedisore. Një kundër padi është njëkohësisht jo vetëm një pengesë e madhe, por edhe një teknikë e dobishme. Lidhja më e drejtpërdrejtë me çështjet gjyqësore për pjesëmarrjen publike ka të bëjë me paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike, siç u përshkrua më sipër.

5.2 Kostot

Deri në një farë mase, kostot gjyqësore përbëjnë një pengesë për t'ju drejtuar sistemit gjyqësor për çështjet që lidhen me mjedisin. Raste të tilla zakonisht kërkojnë vlerësime të kushtueshme, gjetjen e ekspertëve dhe përfshirjen e institucioneve profesionale. Pavarësisht Ligjit për Ndihmën Juridike Falas dhe për mundësinë e përjashtimit nga shpenzimet e procedurave gjyqësore për individët sipas përcaktimeve në ligj, administrimi dhe procedurat që duhen ndjekur, dokumentacioni që individit duhet të dorëzojë në gjykatë si dhe kërkesa për të rifituar të drejtën janë pengesa të mëdha dhe dekurajuese.

Ligjit për Ndhimën Juridike Falas përcakton që ndihma ligjore mund ti jepet qytetarëve shqiptarë dhe të huaj që banojnë në Shqipëri, të cilët (a) pavarësisht të ardhurave të tyre i takojnë njëres prej kategorive të përcaktuara në Nenin 11 të Ligjit për Ndhimën Juridike Falas, të cilat janë viktimat e dhunës në familje, minorenët që janë nën kujdesin e shtetit ose që janë në skemat e mbrojtjes sociale etj. ose (b) që kanë të ardhura të pakta financiare. Për këtë arsye, në çështjet mjedisore që i drejtohen gjykatës, ndihma ligjore në formën e këshillimit ligjor, të përfaqësimit ligjor apo të përjashtimit nga pagesat gjyqësore mund tu jepet vetëm atyre që e kërkojnë që kanë të ardhura të pakta financiare siç përshkruhet në Nenin 12 të këtij ligji.

Ligji për Ndhimën Juridike Falas nuk u jep mundësi të përfitojnë ndihmë juridike falas personave juridikë. Për këtë arsye OJFtë nuk kanë mundësi të marrin këshillim ligjor falas, përfaqësim ligjor apo përjashtim prej pagesave gjyqësore. Për këtë arsye, pagesat gjyqësore përbëjnë një pengesë për OJFtë mjedisore që ti drejtohen gjykatës për çështje mjedisore për raste që mund të trajtohen sipas Konventës së Arhusit.

5.3 E drejta e OJFve për t'ju drejtuar gjykatës

Konventa e Arhusit i jep të drejtë OJFve ti drejtohen gjykatës (p.sh e drejta për të cuar një çështje në gjyq). Për të kundërshtuar procedurat e pjesëmarrjes së publikut në procesin e vendimmarrjes, nuk është e nevojshme që OJFja të jetë e prekur drejtpërsëdrejti prej një vendimi të marrë sikundërse mund të jetë një individ i caktuar. Është e mjaftueshme që një OJF të jetë e interesuar për mbrojtjen e mjedisit. Ky fakt mund të provohet me lehtësi duke ju referuar interesit për mbrojtjen e mjedisit në dokumentat ligjore të organizatës ose duke sjellë prova rreth veprimtarisë së vazhdueshme në këtë fushë. Problemet mund të lindin kur referohen detyrimet prej Konventës në legjislacionin vendas.

Neni 5 pika 12 e Ligjit për mbrojtjen e mjedisit, i cili i referohet Nenit 2.5 të Konventës së Arhusit, shprehet se OJFtë njihen si publik i interesuar. Këto janë "organizata joqeveritare që punojnë për mbrojtjen e mjedisit dhe plotësojnë kërkesat sipas ligjit të vendit". Kjo referencë me ligjin e vendit mund të na çojë në një situatë ku vetëm grupimet e rregjistruara mund ta përdorin të drejtën e dhënë prej Konventës, përfshirë edhe të drejtën për t'ju drejtuar gjykatës dhe të çojnë një çështje për shqyrtim në të.

Në rastet kur rregjistrimi i organizatave të shoqërisë civile është thjesht formalitet, kërkesa të tilla lidhur me ligjin vendas përbëjnë rrallë pengesa për t'ju drejtuar gjykatës.

Megjithatë pengesa serioze për të drejtën e publikut për t'ju drejtuar gjykatës paraqiten në vendet ku rregjistrimi i organizatave të shoqërisë civile është një procedurë e ndërlikuar. Të gjitha vendet palë të Konventës, në të cilat rregjistrimi i një organizate kërkon një procedurë të gjatë dhe të paarsyeshme, është i shtrenjtë ose i kushtëzuar me kërkesa të paarsyeshme, konsiderohen se nuk zbatojnë detyrimet që lindin prej kësaj Konvente.

Rregjistrimi i një OJFje zakonisht është i kushtëzuar prej elementëve të mëposhtëm: në varësi të llojit të organizatës mund të ketë një ose më shumë themelues, aktin e themelimit, statutin që përmban qëllimin dhe objektivat e organizatës në përputhje me Kushtetutën e vendit dhe statusin jofitimprurës të saj.

Në Shqipëri, procesi i rregjistrimit mund të konsiderohet i kushtueshëm dhe i gjatë. Procedura e rregjistrimit kryhet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila kërkon kopje të noterizuara (që e rritin koston e procesit) dhe ndjek procedurat e përshkruara në Kodin e Procedurës Civile për shqyrtimin apo rrëzimin e kërkesës. Ligji për Organizatat Jofitimprurëse rregullon themelimin dhe përfundimin, statusin, drejtuesit, financimet dhe çështje të tjera të rëndësishme për punën dhe veprimtarinë e OJFve. Për çështjet e veprimtarisë dhe të financave, OJFtë veprojnë sipas parashikimeve të Ligjit për Taksat dhe Ligjit të Kontabilitetit. Ky kuadër ligjor përbën një pengesë të madhe për veprimtarinë e përditshme të OJFve lidhur me fuqinë punëtore dhe shpenzimet financiare.

6. Proceset e apelimit ndërkombëtar

Në rastet kur e drejta për t'ju drejtuar gjykatës nuk u garantohet qytetarëve, ka mundësi të tjera për të detyruar qeveritë të zbatojnë kërkesat e Koneventës së Arhusit. Këto janë mundësi për të apeluar në nivel ndërkombëtar për rastet e shkeljes së Konventës. Ato janë mundësi juridike dhe jo juridike, të cilat sikundërse edhe në rastin e mundësive brenda vendit, kanë anët pozitive dhe negative.

Megjithatë në çdo rast, kushti është që të jenë shterrur të gjitha rrugët që përcaktohen me ligj brenda vendit. Përpara se ti drejtoheni një gjykate ndërkombëtare apo një komiteti ndërkombëtar, një person duhet të ketë provuar të gjitha mjetet brenda vendit. Në praktikë, kjo nënkupton që nëse banorëve të fshatit Bënçë vijon tu refuzohet kërkesa për informacion prej një agjencie mjedisi, ata mund të apelojnë në një organ më të lartë dhe/ose në sistemin gjyqësor, e kështu me rradhë deri në hallkën më të fundit të sistemit gjyqësor. Nëse ata humbasin në gjyq, atëherë mund të depozitojnë ankesën e tyre në Komitetin e Pajtueshmërisë së Konventës.

Një shembull tjetër mund të jetë nëse banorët apelojnë në gjykatat vendase dhe çështja e tyre nuk pranohet ndonëse është e mirëargumentuar. Në mënyrë të ngjashme, nëse dëgjimi i palëve vonohet pa shkak ose zgjatet shumë derisa humbet kuptimi i vendimit, atëherë ata mund ta dërgojnë çështjen në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Pas kësaj faze, ata nuk mund ta kundërshtojnë më refuzimin për dhënien e informacionit, meqë Gjykata Evropiane merr në shqyrtim vetëm rastet që rrjedhin prej shkeljes së Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Megjithatë ata mund ti drejtohen gjykatës lidhur me të drejtën e tyre për të pasur procesin e duhur gjyqësor, i cili përmban dëgjimin e drejtë dhe të barabartë të palëve dhe mundësinë për t'ju drejtuar gjykatës në mënyrë kuptimplote. Këto mundësi përshkruhen me hollësi në vijim.

6.1 Mekanizmi i pajtueshmërisë dhe shqyrtimit të zbatimit

Neni 15 i Konventës së Aarhusit përshkruan detyrimin që Palët e kësaj konvente të themelojnë Mekanizmin e Pajtueshmërisë për të ndihmuar vlerësimin e pajtueshmërisë së palëve të veçanta me kërkesat e Konventës. Mekanizmi i Pajtueshmërisë i Konventës së Aarhusit është ngritur dhe miratuar në mbledhjen e parë të Palëve në vitin 2002. Për vetë karakterin specifik të Konventës, mekanizmi është progresiv dhe novator.

Me ratifikimin e Konventës, Palët kanë pranuar detyrimet ndaj publikut, më shumë se detyrimet e ndërsjellta. Për këtë arsye u ngrit mekanizmi në fjalë, që të vlerësojë se si çdo Palë e zbaton konventën në vendin e saj. Ai është i përbërë prej dy pjesëve kryesore: njëra që vlerëson shkallën e zbatimit dhe tjetra është Mekanizmi i Pajtueshmërisë.

Reportimi mbi zbatimin e detyrimeve të Konventës

Raporti përmban një listë të kriterëve, e cila përdoret prej Palëve për të vlerësuar kapacitetet e veta. Ky raport vlerësimi paraqitet në Mbledhjen e Palëve dhe ju shpërndahet Palëve, publikut dhe çdokujt që është i interesuar.

Përfshirja e publikut

Rruga më e dobishme dhe më efektive për autoritetet drejtuese (zakonisht përmes pikës fokale të Konventës së Arhusit në Ministrinë e Mjedisit) është të kryejnë konsultimin me publikun gjatë përgatitjes së raportit. Procesi i pjesëmarrjes gjatë hartimit të raportit mund të bëhet nëpërmjet:

- shpërndarjes së draft raportit zyrtar për publikun;
- organizimit të diskutimeve publike rreth raportit; dhe
- pranimi i komenteve mbi draft raportin

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka përvojë të mirë në përfshirjen e OJFve dhe të publikut të interesuar gjatë hartimit të raportit dhe në organizimin e diskutimeve publike.

Ndikimi mbi përmirësimin e zbatimit

Raportimi i rregullt rreth zbatimit dhe botimi i raporteve synon të nxisë Palët që të përmirësojnë zbatimin e Konventës në çdo vend si në plotësimet ligjore të domosdoshme dhe zbatimin praktik të tyre.

Komiteti i Pajtueshmërisë

Në shtesë të shqyrtimit të raporteve rreth zbatimit të Konventës prej Palëve, Mbledhja e Palëve ka ngritur edhe një Komitet të Pajtueshmërisë.

Komiteti është i përbërë prej tetë ekspertëve të emëruar prej Palëve, si dhe OJFve mjedisore. Anëtarët zgjidhen nga një listë e propozuar kandidatësh në Mbledhjen e zakonshme të Palëve, dhe katër anëtarë zëvendësohen me rrotacion çdo katër vjet. Lista e anëtarëve të tanishëm mund të gjendet në faqen e internetit të UNECE:

<https://www.unece.org/environmental-policy/conventions/public-participation/aarhus-convention/tfwg/envppcc/aarhuscc-members.html>

Si të propozojmë një anëtar në Komitetin e Pajtueshmërisë

Kush mund të propozojë?

- Një qeveri ose një OJF mjedisore (që përmbush kërkesat e Nenit 2 të Konventës). Shumica e vendeve kërkojnë rregjistrimin e të drejtës për tu zgjedhur në mënyrë që të propozojnë.

PRACTICAL TIP

When preparing documentation, it is advisable to turn to legal experts for help. The committee operates in English.

Although the official languages of the convention secretariat are English, Russian and French, the review will be considerably accelerated if it is requested in English.



Kush mund të propozohet?

- Një shtetas i çdo vendi që ka nënshkruar, ratifikuar dhe miratuar ose aderuar në Konventën e Arhusit (një vend nënshkruar ose Palë).
- I propozuari pritët të jetë tepër i njohur me fushat e veprimit të Konventës.
- Është e preferueshme, por jo e domosdoshme që i propozuari të ketë përvojë juridike.

Cilin të propozojmë

Çdo propozim duhet shoqëruar me CV e kandidatit (jo më shumë se 600 fjalë) dhe dokumenta të tjera mbështetës që mund të konsiderohen të dobishëm. Propozimi duhet dorëzuar në sekretariatit të Konventës të paktën tre muaj përpara Mbledhjes së zakonshme të Palëve.

Funksionet e Komitetit të Pajtueshmërisë

- TKomiteti shqyrton dhe vlerëson aplikimet prej:
 - palëve;
 - individëve ose OJFve; dhe
 - sekretariatit të Konventës.
- Si një organi jo juridik, ai bën rekomandime lidhur me pajtueshmërinë e një pale të veçantë për një rast të përcaktuar ose për mos përputhshmëri me parimet e Konventës në përgjithësi.
- Komiteti përbëhet nga individë ekspertë. Megjithëse të propozuar prej Palëve dhe OJFve, anëtarët janë shumë të respektuar dhe të mirënjohur si profesionistë ligjorë, të cilët nuk përfaqësojnë qeveritë e tyre, por veprojnë si ekspertë të pavarur.

Komunikimet nga publiku

Një ose më shumë anëtarë të publikut mund të komunikojnë me Komitetin përmes sekretariatit në formë të shkruar (të shtypur ose në format elektronik) për pajtueshmërinë e njërës prej palëve. Komunikimi duhet të shoqërohet me dokumentacionin vërtetues (prova të mospajtueshmërisë me Konventën) — me fjalë të tjera, procesi është i ngjashëm me dorëzimin e padisë në një gjykatë. Informacioni i hollësishëm për komunikimet mund të gjendet në faqen e internetit të UNECE: <http://www.unece.org/env/pp/cc/com.html>

Komunikimi i drejtpërdrejtë nga publiku

Komunikimi i drejtpërdrejtë nga publiku:

- duhet bërë duke përdorur forma të ndryshme, komunikimi në formë të shkruar nuk është i parapëlqyer;
- duhet të jetë anonim (individët që bëjnë një komunikim duhet të kërkojnë nga Komiteti i Pajtueshmërisë që të ruajë sekretin lidhur me identitetin e tyre nëse kanë frikën e persekutimit apo të kërcënimit);
- nuk duhet të përbëjë abuzim me të drejtën për të bërë komunikime të tilla;
- nuk duhet të shfaqë mungesë arsyeje;
- duhet të plotësojë kërkesat lidhur me formën dhe subjektin e çështjes në vendimin e Palëve të Mekanizmit të Pajtueshmërisë; dhe
- duhet të jetë në përputhshmëri me Konventën e Arhusit.

Përrjashtime

Një palë duhet të njoftojë se është e pamundur të pranojë shqyrtimin e një çështje që lidhet me pajtueshmërinë prej këtij Komiteti për një periudhë deri në katër vjet. Kjo dispozitë “e ashtuquajtur dispozitë përjashtuese” është vendosur për ti lejuar palëve të ndryshojnë dhe sjellin legjislacionin dhe praktikën e ndjekura në vend në përputhje me Konventën. Palës njoftuese i jepet një periudhë e caktuar kohore gjatë së cilës ajo duhet të përmbushë këto detyrime. Megjithatë kjo është një dispozitë e veçantë që pranon se vendi aplikues për përjashtimin nga shqyrtimi është de facto në papajtueshmëri me konventën. Njoftimi për përjashtim të përkohshëm duhet dorëzuar me shkrim në Zyrën e Traktateve të OKBsë në Nju Jork (e njëjta zyrë ku ratifikohen, pranohen ose miratohen dokumentat e dorëzuara). Një Palë mund të tërhiqet nga përjashtimi në çdo kohë.

Procesi

- TKomiteti i Pajtueshmërisë njofton Palën e akuzuar për papajtueshmëri.
- Pala ka kohë deri në pesë muaj për të dhënë shpjegime.
- Pas skadimit të afatit kohor prej pesë muajsh, Komiteti i Pajtueshmërisë vlerëson komunikimin dhe jep shpjegime sa më shpejt të mundet për arsye praktike (më së shumti në sesionin e planifikuar të rradhës).
- Komiteti mund të kërkojë dëgjuesën e palëve (ngjashëm më dëgjuesën e palëve në gjykatë).



Udhëzime praktike

Gjatë përgatitjes së dokumentacionit është e këshillueshme të kërkohet ndihma e ekspertëve ligjorë. Komiteti punon në gjuhën Angleze.

Ndonëse gjuhët zyrtare të sekretariatit të Konventës janë Anglisht, Rusisht dhe Frengjisht, shqyrtimi bëhet më i shpejtë nëse kërkohet në gjuhën Angleze.

Çfarë mund të arrihet në Mbledhjen e Palëve?

Bazuar në raportin dhe/ose rekomandimet e Komitetit të Pajtueshmërisë, Mbledhja e Palëve mund të marrë masat e mëposhtme lidhur me Palën në diskutim:

- prapë këshilla, rekomandime ose mbështetje;
- kërkojë që Pala të dorëzojë një strategji në Komitetin e Pajtueshmërisë, duke përfshirë afatet kohore për përmbushjen e veprimeve e planifikuara për të arritur pajtueshmërinë;
- rekomandojë marrjen e masave të veçanta;
- deklarojë një palë që është në papajtueshmëri;
- paralajmërojë një palë; dhe
- pezullojë privilegjet prej konventës (kjo është një dispozitë standarte që nuk ka ndonjë ndikim të madh mbi Palën). Megjithatë kjo dispozitë mund të shtrihet jozyrtarisht në dhënien e ndihmës teknike për Palën në kuadër të Konventës, siç mund të jetë dhënia e fondeve për projekte.

Ndonëse të gjitha këto masa nuk janë me efekte juridike dhe nuk kanë natyrë konfrontuese, papajtueshmëria është një çështje serioze që duhet vlerësuar me seriozitet nga vendet. Mekanizmi i Pajtueshmërisë është një mjet i mirë, përmes së cilit diskutohet çështja e pajtueshmërisë me Konventën.

7. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut nuk merret drejtpërdrejt me çështjet mjedisore apo të të drejtën për të marrë pjesë. Por megjithatë ajo ka marrë disa vendime që përbëjnë precedentë dhe ka interpretuar disa nga dispozitat e Konventës lidhur me të drejtat mjedisore si dhe të drejtën e privacisë, të drejtën për t'ju drejtuar gjykatës dhe të drejtën për të pasur një proces të drejtë.

Dërgimi i një çështjeje në Gjykatën e Strasburgut është i vështirë dhe kërkon një kohë të gjatë disavjecare, por është mundësia e fundit dhe ka ndikimin më të madh për rastet individuale, praktikant gjyqësor të vendeve dhe në interpretimin ndërkombëtar.

Procedurat e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut janë shumë specifike dhe shterrja tërësore e të gjitha rrugëve ligjore të vlefshme në vend është parakusht kryesor për fillimin e procedurës në këtë gjykatë.

Burimet të dobishme informacioni

Faqja e Politikave Mjedisore të UNECE

<http://www.unece.org/env/pp/introduction.html>

Bashkëpunimi dhe Zhvillimi Ndërkombëtar i Komisionit Evropian: Instrumenti Evropian për Democracinë dhe të Drejtat e Njeriut

https://ec.europa.eu/europeaid/european-instrument-democracy-and-human-rights_en

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

<http://mjedisi.gov.al/>

Agjencia Kombëtare e Mjedisit

www.akm.gov.al/

Gjykatat në Shqipëri

<http://gjykata.gov.al/>

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit

<http://www.idp.al/>

Avokati i Popullit

<http://www.avokatipopullit.gov.al/>